



Bankieri

Botim Nr. 34
Janar 2020

ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE



RIMODELIM EKONOMIK?



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Shoqata Shqiptare e Bankave në ndihmë të pasojave të tërmetit të datës 26 nëntor 2019:

- * Dhurim në shumën 200,000 (dyqind mijë) Euro.
- * Heqje e tarifave dhe komisioneve të aplikuara për transaksionin financiar (vendas dhe ndërkombëtar) për transferimin e fondeve në favor të viktimave të tërmetit.
- * Kontribute të tjera të kryera nga anëtarët individualë të AAB-së bazuar në rregullat dhe politikat e tyre.
- * Trajtim rast pas rasti i huamarrësve që janë dëmtuar nga tërmeti.

ANËTARËT E AAB-së

 ALPHA BANK	 abi AMERICAN BANK OF INVESTMENTS	 BKT BANKA KOMBETARE TREGTORE	 CREDINS bank
 Fibank First Investment Bank	 INTESA SANPAOLO BANK Albania	 otpbank	 ProCredit Bank
 Raiffeisen BANK	 TIRANA BANK	 UNIONBANK	 UBA Banka e Bashkuar e Shqiptarisë United Bank of Albania

PËRMBAJTJA

Bankieri

Nr. 34, Janar 2020

Botim i Shoqatës Shqiptare të Bankave



REDAKSIA:

Elvin Meka

Kryeredaktor

Eftali Peçi

Koordinatorë Produsioni

Junida Tafaj (Katroshti)

Bashkëpunëtore

Dorina Zarka

Fotografe**Design & Layout:** FCB Afirma**Shtypi nga:** Gent-grafik

Bankieri është publikimi zyrtar i Shoqatës Shqiptare të Bankave i cili i dedikohet kryesisht sektorit bankar shqiptar. Bankieri i jep lexuesit një informacion të vlefshëm mbi arritjet e industrisë në përgjithësi dhe të bankave tregtare në veçanti.

SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Rr. Ibrahim Rugova,

SKY TOWER, 9/3, Tiranë

Tel: +355 4 2280371/2

Fax: +355 4 2280 359

www.aab.al

Editorial

Modelimi i ri ekonomik, ose ndërtimi i Shqipërisë për brezat e ardhshëm

Prof. Asoc. Dr. Elvin MEKA

5

Intervista

Bankat në Shqipëri në vitin 2019 dhe horizonti për 2020-ën

Intervistë me drejtorët e përgjithshëm të bankave anëtare të AAB-së

Rimodelimi ekonomik i Shqipërisë: Një përpjekje shumë-planëshe

Anita DENAJ, Ministër

6

15

Tema e Ditës

Modeli i ri ekonomik për Shqipërinë Nevoja për kapital njerëzor të kualifikuar dhe infrastrukturë teknologjike

Prof. Dr. Luljeta MINXHOZI

17

Sistemi Bankar

Sistemi bankar në Bosnjë Hercegovinë I angazhuar në një proces të përhershëm rritjeje

Berislav KUTLE

19

Kolateralit alternativ Një mundësi më shumë për zgjerimin e huadhënies

Admira LLAZARI (Mlika)

22

Kur ndryshimet ligjore kalojnë pa proces konsultimi

Brunilda KOSTARE

24

Informaliteti i lartë i ekonomisë dhe përdorimi i ulët i kartave dhe terminaleve bankare

Diana LEKA

27

Hezitimi i bashkëpunimit me bankën dhe informaliteti Pengesa serioze në rritjen e përdorimit të kartave dhe POS-eve

Erion MAXHARI

29

Forumi i Ekspertëve

Siguria kibernetike në një botë të ndërlidhur

Gizem TANSU, ICA

30

Përgjegjësia Sociale - një urë drejt Zhvillimit të Qëndrueshëm

Ardita SEKNAJ

33

Shkaqet dhe pasojat e luftërave tregtare - fituesit dhe humbësit

Prof. Dr. Adrian CIVICI

35

Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm

37

AAB: Aktivitete Trajnime

43

BORDI EDITORIAL:

Silvio PEDRAZZI

Kryetar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm, Intesa Sanpaolo Bank Albania

Georgios PAPANASTASIOU

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm, Alpha Bank Albania

Ervin KOÇI

Drejtor Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare

Maltin KORKUTI

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm, Credins Bank

Dritan MUSTAFA

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm, Tirana Bank

Adrian CIVICI

Dekan Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

Andi BALLTA

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm, American Bank of Investments

Spiro BRUMBULLI

Sekretar i Përgjithshëm, Shoqata Shqiptare e Bankave

3 **NORMË**
INTERESI
NGA
0%
2.000.000 LEKË
PA KOLATERAL

Tek ty shohim më të mirën!

Punët e mira, bëhen shpejt e shpejt!

Normë interesi nga 3%! Miratojmë për 24 orë!

Shumë financimi deri në 2,000,000 Lekë;

Afat shlyerje deri në 7 vjet;

Financim të menjëhershëm dhe lehtësi në përdorim të huasë;

Këste mujore të pandryshueshme për të gjithë kohëzgjatjen e kredisë.

Na kontaktoni në:

www.otpbank.al • 0800 48 48 (pa pagesë) / +355 68 40 12 121 / +355 69 40 12 121

Modelimi i ri ekonomik, ose ndërtimi i Shqipërisë për brezat e ardhshëm



Prof. Asoc. Dr. Elvin MEKA¹
Kryeredaktor

Thuajse tre dekada më parë, Shqipëria hyri në rrugën e madhe të kapitalizmit dhe ekonomisë së tregut, duke lënë pas ekonominë e centralizuar komuniste, e cila në fazën e fundit e solli atë në vijën e ekzistencës dhe vdekjes klinike. Në këtë aspekt, Shqipëria e ka bërë tashmë zgjedhjen e saj: ajo zgjodhi kryesisht kapitalizmin klasik dhe atë liberal. Në fillim të viteve nëntëdhjetë, u kryen reforma të shumta e të dhimbshme sociale dhe ekonomike, për ta shndërruar ekonominë e vendit në një ekonomi tipike kapitaliste dhe sot, pas një tranzicioni dhe transformimi të thellë politik, ekonomik dhe social, Shqipëria dhe ekonomia e saj ka arritur në pikën që kjo e fundit ka nevojë për reflektim dhe një qasje të re, drejt një modelimi të ri.

Në terma praktikë, në rastin e Shqipërisë, mund të flasim vetëm për modelimin e ri ekonomik, sesa të mendojmë, të shpikim ose të zgjedhim një model ekonomik të ri. Ky modelim i ri ekonomik

nuk është një çështje zgjedhjeje midis kapitalizmit liberal dhe atij politik; përkundrazi ka të bëjë me vendimet për të siguruar një ri-pozicionim optimal dhe më mirë funksional të gjashtë llojeve të kapitaleve, brenda sistemit ekonomik, të cilat janë: kapitali i biznesit, kapitali infrastrukturor, kapitali njerëzor, kapitali social, kapitali intelektual dhe ai natyror. Modeli aktual ekonomik, si dhe formatimi i gjashtë kapitaleve të mësipërme, të cilin Shqipëria e ka përdorur për shumë vite me radhë, i ka mundur vendit që të shënojë një periudhë relativisht të gjatë e të vazhdueshme me rritje pozitive ekonomike, por jo krejt të mjaftueshme për të gjeneruar mirëqenie të qenësishme dhe të qëndrueshme, për të gjithë qytetarët. Thënë thjesht, ky sistem dhe format ekonomik nuk ka prodhuar, deri më tani, një model të qëndrueshëm për zhvillimin ekonomik, dhe një gjë e tillë duhet të ndryshojë.

Rimodelimi i vënë për diskutim së fundi për ekonominë kombëtare me të vërtetë ka nevojë për një kuptim më të mirë të rolit të veçantë, që secili lloj i kapitalit mund dhe duhet të luajë, brenda kornizës së kontributit të tyre në rritjen ekonomike. Për më tepër, ajo kërkon gjetjen e rrugëve për të energjizuar kapitalet e sipërpërmendura, në një mënyrë të tillë që, fuqizimi i njërit prej tyre të mund të fuqizojë dhe të stimulojë reciprokisht të tjerët dhe anasjelltas. Sigurisht që, në këtë peizazh kompleks, aktorë të ndryshëm kanë rolet e tyre përkatëse, por padyshim që është

qeveria ajo që duhet të luajë rolin më të madh, pasi shumica e zhvillimit dhe rritjes së këtyre kapitaleve varen, në një formë ose tjetër, nga mënyra se si qeveria i vendos prioritetet e zhvillimit dhe sa efektive dhe efikase janë investimet e saj. Në këtë kuadër, kur qeveria të vendosë prioritetet sipas modelimit të ri ekonomik, ajo duhet marrë në konsideratë edhe mjaft çështje komplekse, si: zvogëlimi i vazhdueshëm i popullatës, produktiviteti i ulët, fuqia punëtore e pakualifikuar dhe e pa trajnuar, shkalla e ulët e industrializimit, bujqësia e pazhvilluar, industria modeste agro-përpunuese, shkalla e lartë e ekonomisë informale, infrastruktura modeste e IT, tregje financiare rudimentare dhe tradicionale, etj., së bashku me hartimin e strategjive të qëndrueshme të investimeve afatgjata dhe gjetjen e mënyrave për të shlyer ato, pa kosto dhe barrë të konsiderueshme për buxhetin e shtetit, në afatgjatë. Me pak fjalë, një rimodelim i tillë ekonomik kërkon që qeveria të ndërtojë vizion dhe të mendojë në avancë dhe mbi baza afatgjata.

Për ta mbyllur, Shqipëria duhet të zhvillojë një ekonomi që prodhon pasuri dhe mirëqenie për masat, lehtëson pabarazinë, promovon konkurrencën dhe punon në një mjedis të shëndetshëm biznesi, dhe mbi të gjitha, një ekonomi që krijon një vlerë të vërtetë të shtuar ekonomike për të gjithë shoqërinë, dhe jo thjesht një vlerë mekanike për një pjesë të saj!

¹Dekan i Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, Universiteti Europian i Tiranës, UET


INTERVISTA

Bankat në Shqipëri në vitin 2019 dhe horizonti për 2020-ën

Intervistë me drejtorët e përgjithshëm të bankave anëtare të AAB-së

BANKIERI:

1. Një tjetër vit me sfida, si viti 2019, u mbyll për sektorin bankar shqiptar. Si ishte ecuria e bankës suaj, arritjet dhe zhvillimet kryesore në këtë drejtim?
2. Sipas këndvështrimit të bankës suaj, cilat janë sfidat kryesore për sistemin bankar shqiptar, në vazhden e formësimit dhe jetësimit të rimodelimit të ekonomisë kombëtare, në të ardhmen e afërt dhe më tej?



BANKA KOMBËTARE TREGTARE

Seyhan Pencabligil

Drejtor i Përgjithshëm
& Anëtar Bordi

1 Ne arritëm thujasë të gjithë objektivat tona financiare dhe operationale të vitit 2019. Kthimi nga kapitali për vitin ishte 17 % në dollarë amerikanë, që është mjaft i kënaqshëm, në veçanti duke pasur parasysh që deri më sot jemi banka më e madhe në vend. BKT

përshpejtoi investimet në teknologji, përtëpërmirësuar cilësinë e shërbimit. Rrjeti i ATM-ve u rinovua me modelin e fundit të makinave që riciklojnë paratë; platformat e-banking dhe bankingu nëpërmjet celularit mbeten udhëheqës të sektorit, etj. Gjithashtu, banka riorganizoi strukturën e zyrave qendrore dhe ndërmori një rotacion në shkallë të gjerë të stafit menaxherial, në të gjithë bankën. Falë këtyre arritjeve, BKT u vlerësua përsëri si banka më e mirë në vend, nga revistat The Banker, Euromoney, Global Finance dhe EMEA Finance, në vitin 2019.

2 Sfidat kryesore për bankat është që raporti i huave me probleme, i cili edhe pse ka rënë në mënyrë të qëndrueshme, mbetet ende i lartë, veçanërisht në kontekstin e normave shumë të ulëta të interesit. Sistemi bankar duhet t'i edukojë korporatat që të përmirësojnë qeverisjen e tyre, në mënyrë që nivele të tilla të ulëta të interesit, veçanërisht në Euro, të jenë të justifikuar. Edhe korporatat më të

mëdha në vend nuk prodhojnë pasqyra financiare të audituara nga auditues të pavarur ndërkombëtarë, por nga ana tjetër, presin të financohen me interesa shumë të ulëta.

Sfida e dytë e madhe për bankat është mungesa e projekteve të mëdha dhe të realizueshme. Përveç PPP-ve, të cilat janë politizuar dhe bërë shumë të diskutueshme, shumë pak projekte të mëdha vijnë mbi tavolinat tona. Shumica e veprimtarisë aktuale të departamenteve të korporatave të bankave ka të bëjë me ri-financimin e klientëve ekzistues të bankave të tjera, me kushte edhe më të favorshme.

Së fundi, të gjitha bankat duhet të shkenden nga fakti që kërcënimi nga fintech-sat është pas kthesës. Bankat ose do digjitalizohen, ose do vdesin. Neve na është prishur gjumi prej këtij fakti, pasi edhe nëse je banka më e mirë në vend, mund të humbasësh klientët krejt papritur, për shkak të Google, ose Amazon.



RAIFFEISEN BANK ALBANIA
Christian Canacaris
 Drejtor i Përgjithshëm

1 Viti 2019 ishte përgjithësisht një vit i kënaqshëm për Raiffeisen Bank Shqipëri. Ato pak sfida që kemi pasur gjatë kësaj periudhe nuk e kanë frenuar ecurinë e mirë të saj. Portofoli ynë i huas u rrit në të gjitha segmentet. Ne vijum të përqendrohemi në bankingun digjital; jemi krenarë që jemi banka e parë në treg me një *chatbot* (robot folës), duke qenë udhëheqës tregu kur bëhet fjalë për t'i dhënë bankingut një dimension novator. Ne gjithmonë i kemi shtyrë më larg kufijtë e *status-quo*-së, për të sjellë më shumë vlerë për klientët tanë. Banka nuk humbi kohë për të kuptuar se sektori bankar së shpejti do të përballej me "shpërthimin" e ardhshëm digjital, kështu që ai u bë atë prioriteti ynë kryesor për të ndërmarrë një strategji ambicioze për të transformuar përvojën bankare të klientit tonë. Kjo është arsyeja pse ishim të parët në treg me *Raiffeisen On*, platformën tonë digjitale në internet dhe celular, *RONA*-n asistenten në internet, të bazuar në inteligjencën artificiale, *KUIK* dhe *Scan & Pay* - mjetet tona të pagesës së menjëhershme klient-përklient dhe klient-për-biznes, si dhe *Smart Pay* - mikrokartën që mbahet me vete. Çka është më e rëndësishmja,

digjitalizimi ka potencialin për të rritur përfshirjen sociale financiare, për njerëzit që jetojnë në zona të thella, me qasje të vështirë në zyrat bankare. Ne dëshirojmë t'ua bëjmë më të lehtë jetën klientëve tanë, përmes gjithë lehtësive që u ofrojmë atyre.

Po ashtu, këtë vit ishte dhe 15 vjetori i bankës dhe siç mund të imagjinohet, ishte një vit i veçantë për ne për të reflektuar dhe vlerësuar se çfarë kemi bërë deri më sot e gjithashtu të planifikojmë për më shumë të reja që do sjellim në treg.

2 Disa javë më parë, Shqipëria u përball me një tërmet tragjik. Sistemi bankar do të angazhohet për të ndihmuar në rimëkëmbjen e klientëve që pësuan fatkeqësi, duke shtyrë pagesat e huave ose duke i fshirë ato.

Digjitalizimi do të vijojë të jetë fokusi ynë kryesor gjatë gjithë vitit, për të ulur nivelin e përdorimit të parasë së gatshme në nivel klienti. Raiffeisen Bank do të vazhdojë të sjellë risi në tregun bankar shqiptar, duke ofruar gjithmonë produkte dhe zgjidhje novatore për klientët. Procesi i digjitalizimit ka filluar dhe sistemi bankar është në krye të tij, por është e nevojshme që të vazhdojmë të investojmë, për t'i ofruar klientit tonë shërbimin më të mirë përmes kanaleve digjitale, siç edhe po veprojmë aktualisht.

Gjithashtu, ne do të vijojmë të kreditojmë ekonominë në të gjitha segmentet, siç bëmë edhe vitin që shkoi. Kështu, shpresojmë të ndikojmë në rigjallërimin e ekonomisë dhe nisjen e projekteve të reja.



CREDINS BANK
Maltin Korkuti
 Drejtor i Përgjithshëm

1 Viti 2019 u mbyll me një ecuri të kënaqshme, duke përmbushur me sukses objektivat strategjike, të vendosura në fillim të vitit nga bordi drejtues dhe aksionarët e bankës. Pavarësisht sfidave të vazhdueshme, të hasura përgjatë vitit, të lidhura me situatën e përgjithshme ekonomike globale, ndryshimet në rritjet e kërkesës rregullatore, luhatjet e kurseve të këmbimit, proceset e konsolidimit të sistemit bankar, Credins Bank arriti të ruajë me sukses një pozicion të shëndetshëm të likuiditetit, huas me probleme, rritjes së të ardhurave, dhe konsolidim të kënaqshëm të marrëdhënieve me klientët.

Fokusi i drejtuesve dhe i stafit të bankës ka qenë mbështetja e vazhdueshme e bizneseve të vogla e të mesme, si shtylla kryesore e zhvillimit të ekonomisë së vendit dhe rritjes së punësimin. Për t'i mundësuar biznesit të vogël akses në financim, krijuam skema lehtësuese me partnerë ndërkombëtarë, siç është marrëveshja COSME me Fondin Evropian të Investimeve, si dhe krijimi i paketave specifike për këtë segment klientësh.

Ne mbështetëm fort Agrobiznesin, si një nga sektorët më prioritarë dhe strategjikë në vend, duke qenë të

BANKIERI:

1. Një tjetër vit me sfida, si viti 2019, u mbyll për sektorin bankar shqiptar. Si ishte ecuria e bankës suaj, arritjet dhe zhvillimet kryesore në këtë drejtim?
2. Sipas këndvështrimit të bankës suaj, cilat janë sfidat kryesore për sistemin bankar shqiptar, në vazhden e formësimit dhe jetësimit të rimodelimit të ekonomisë kombëtare, në të ardhmen e afërt dhe më tej?

pranishëm në çdo skaj të vendit, edhe aty ku nuk ka prani bankash, nëpërmjet bankës lëvizëse, një nga shërbimet me novatore të tregut vendas. Krijua paketa të personalizuar për çdo grup klientësh, duke adresuar nevojat e tyre specifike me shërbime bankare dhe komisione preferenciale përgjatë vitit, siç janë: paketat për studentët, bizneset e vogla, klientët agro, etj. Krijua fushata marketingu ndërgjegjësuere, për të ndihmuar reduktimin e informalitetit, nëpërmjet rritjes së pagesave me karta bankare dhe instalimin e POS-eve dhe ofrimin e lehtësisë së pagesave nëpërmjet përdorimit të aplikacionit *Credins Online* nga çdo *tablet* dhe *smartphone*. Trasformimi i vazhdueshëm teknologjik ka qenë prioriteti ynë, i cili u konkretizua në-përmjet modernizimit të aplikacionit *mobile*, në një version më të bukur e të thjeshtë për çdo përdorues.

Programi "YOUARECREDINS", që u lançua në fillim të vitit, është shndërruar në një akademi edukimi dhe punësimi të talenteve të reja dhe sot Credins Bank renditet një nga punëdhënësit më të mëdhenj, me 920 punonjës.

Të gjitha këto pasqyruan një ecuri paraprake të kënaqshme kundrejt 2018-ës. Credins Bank u rendit banka e parë në treg për totalin e portofolit neto të huas, me një vlerë prej 825.6 milionë euro, duke qenë mbështetësja kryesore me financime për çdo biznes dhe individ në vend. Një rritje të kënaqshme patëm dhe në treguesit e tjerë, si rritje 11.1% të depozitave, 10.7% të aktiveve të bankës, 11.2% të numrit të klientëve dhe 5.7% të numrit të punonjësve të bankës.

2 Viti 2020 parashikohet të jetë një tjetër vit sfidash, përballë ekonomisë aktuale të vendit. Banka Credins do vazhdojë të rrisë në mënyrë të kujdesshme portofolin e huas, duke mbajtur nën kontroll portofolin aktual, që shpresojmë të mos ndikohet nga vështirësitë e hasura nga biznese dhe individë të zonave të prekura nga tërmeti. Banka Credins do vazhdojë rritjen në segmentin retail, duke ofruar më shumë produkte novatore, si dhe do mbështesë projekte ambicioze në sektorë interesantë, si: turizmi dhe bujqësia.

Banka do vazhdojë transformimin teknologjik, me projekte shumë interesante, siç është hapja e degës *Smart*, duke ofruar një eksperiencë unike digjitale për çdo klient. Gjithsesi, modernizimi i mëtejshëm teknologjik i sektorit bankar kërkon përmirësime kryesore rregullatore, teknike dhe administrative, për të mbështetur zhvillimet teknologjike, siç është firma digjitale, apo thjeshtësuar më tej proceset dhe procedurat, përmes aplikimeve *online*.

Banka Credins ka qenë mjaft aktive në evidentimin e nevojave të shoqërisë shqiptare dhe hartimin e projekteve, për të ndihmuar lehtësimin e tyre. Përmirësimi i infrastrukturës në arsim, shëndetësi, mjedis, etj., do vazhdojë të jenë në fokus të bankës. Përveç investimeve në infrastrukturën e bankës, do vazhdojmë të jemi të angazhuar në projekte mbi: rritjen e hapësirave të gjelbra, edukimin e brezit të ri, uljen e konsumit të plastikës, etj. Banka Credins do vazhdojë të jetë një nga institucionet kryesore bankare

në vend, duke mbështetur zhvillimin e përgjithshëm të vendit, duke ndikuar në uljen e informalitetit dhe reduktimin e *cash-it* në ekonomi, nëpërmjet produkteve dhe ofertave tërheqëse, si dhe do vijojë të kontribuojë në investime të vazhdueshme të stafi dhe punësimi i mëtejshëm i të rinjve.

Së fundi, Banka Credins pas shumë viteve të suksesshme në tregun shqiptar dhe me ekperiencën e akumuluar në vite, do ndërmarrë një tjetër projekt të rëndësishëm në 2020-ën, duke u zgjeruar në Kosovë dhe duke krijuar mundësi të reja, në një treg më të madh për gjithë klientët dhe investuesit.

**INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA****Silvio Pedrazzi***Drejtor i Përgjithshëm*

1 Para së gjithash, më lejoni të shpreh ngushëllimet e mia personale dhe të gjithë stafit të Intesa Sanpaolo Bank për familjet e viktimave të

tërmetit. Ngjarje të tilla krijuan për të gjithë në një ndjenjë trishtimi që, në një farë mënyre, zbeh kënaqësinë për rezultatet tona. Në realitet na është dashur të përballojmë vërtet një vit sfidues. Sidoqoftë, ecuria e Intesa Sanpaolo Bank është mjaft e kënaqshme, veçanërisht duke marrë parasysh që viti 2019 ishte viti i parë i plotë pas blerjes së Veneto Banka. Banka rriti ndjeshëm, si depozitat e klientëve, ashtu dhe portofolin e huas, duke konsoliduar pozicionin në treg dhe duke regjistruar një fitim neto të shkëlqyer. Për më tepër, unë do të doja të theksoja uljen e mëtejshme të nivelit të huave me probleme – që tani është pothuaj sa gjysma e nivelit mesatar në rang vendi – dhe impulsi mbresëlënës që iu dha kanaleve digjitale, i shoqëruar me zgjerimin e rrjetit fizik. Unë do të pohoja që kemi shkuar përtej pritshmërive tona, duke marrë parasysh kushtet jo aq të lehta në të cilat kemi punuar.

2 Shqipëria, nga disa këndvështrime, mund të thuhet se është në një udhëkryq dhe viti 2020 duhet të konsiderohet thelbësor, për shumë arsye. Unë shpresoj që përmbyllja e një numri reformash, synojnë ta bëjnë tregun më efikas dhe në përputhje me standardet evropiane, duke e ditur që ky udhëtim është kompleks nga shumë paqartësi që po prekin ekonominë evropiane dhe atë botërore, që tashmë kanë ngadalësuar rritjen e PBB-së; të gjitha bankat duhet të kontribuojnë në nxitjen e investimeve të reja në teknologji dhe eficiencë, nga sipërmarrjet vendase, për të mbajtur ritmin e vendeve fqinje. Në të njëjtën kohë, bankat duhet të adoptojnë qasjen më të lartë profesionale të mundshme në veprimtarinë e huadhënies, duke gjetur ekuilibrin e duhur midis oreksit për rrezik, rritjes, qëndrueshmërisë, si dhe *përfitimit*. Kjo nuk do të jetë aspak detyrë e lehtë, nëse marrim parasysh rrethanat aktuale, futjen e kërkesave të reja rregullatore - që

kërkojnë investime të mëdha - dhe në të njëjtën kohë, nivelin jashtëzakonisht të ulët të normave të interesit që ulin fitimet. Në çdo rast, unë mbetem optimist për aftësinë e industrisë bankare shqiptare për të kapërcyer me sukses të gjitha vështirësitë.



OTP BANK ALBANIA

Bledar Shella

Drejtor i Përgjithshëm

1 Viti 2019 ishte një vit shumë i suksesshëm për OTP Bank – Shqipëri. Pas blerjes së aksioneve të Société Générale nga OTP Bank Nyrt, në mars 2019, OTP Bank – Shqipëri u integrua plotësisht në OTP Group. Ecuria financiare ishte gjithashtu shumë e mirë. Ne arritëm të rrisim dukshëm huadhënien, si për individët ashtu dhe për biznesin, dhe rritëm pjesën e tregut në huadhënie, duke u konsoliduar si banka e katërt më e madhe në huadhënie. Cilësia e portofolit të huas vazhdoi të përmirësohet, me një raport të huave me probleme prej 6%, që e pozicionon bankën tonë si banka me raportin më të ulët në sistemin bankar. Përfitueshmëria e këtij viti shënoi nivelin më të lartë historik të bankës sonë, me një fitim neto, sipas të dhënave të nëntorit, prej 11.5 milion Euro dhe 20% kthim nga kapitali. Rrjeti i degëve u zgjerua gjatë vitit, duke hapur degë të reja e gjithashtu, duke

përmirësuar më tej proceset tona. Në përgjithësi, mund të them që ka qenë një vit i shkëlqyer për OTP Bank Albania.

2 Gjatë vitit 2019 ecuria e sistemit bankar ishte përgjithësisht pozitive, veçanërisht në huadhënie. Pas disa vitesh rritje të ngadaltë të huadhënies, në vitin 2019 huadhënia, veçanërisht për individët, ka qenë në nivele të kënaqshme. Sfida e vitit 2020 do të jetë mbajtja e këtij momenti të mirë. Lidhur me ofertën e tregut bankar, shumë banka kanë objektiva ambiciozë dhe duan të rrisin kreditimin. Ndërsa nga ana e kërkesës, mbetet për t'u parë gatishmëria e klientëve, veçanërisht në segmentin e bizneseve, për të filluar projekte të reja dhe për të marrë hua të reja. Rritja ekonomike e Shqipërisë do të jetë gjithashtu një faktor i rëndësishëm. Ne kemi nevojë të shohim nëse ngadalësimi i veprimtarisë ekonomike gjatë muajit të fundit dhe pasojat e tërmetit do të ulin rritjen në vitin 2020, ose më saktë, do të kemi një shtytje për rritjen e veprimtarisë ekonomike.

Një tjetër sfidë mbetet informaliteti. Përveç masave të marra gjatë viteve të fundit, informaliteti mbetet në një nivel shumë të lartë dhe përbën ende rrezik për sistemin bankar. Më shumë duhet të bëhet në këtë drejtim dhe shpresojmë që masat e planifikuara nga qeveria të japin rezultatet e pritura.

Investimet e kërkuara në digjitalizim janë një tjetër sfidë për bankat. Tani digjitalizimi po bëhet realitet dhe bankat duhet të investojnë fonde të konsiderueshme në këtë proces.

BANKIERI:

1. Një tjetër vit me sfida, si viti 2019, u mbyll për sektorin bankar shqiptar. Si ishte ecuria e bankës suaj, arritjet dhe zhvillimet kryesore në këtë drejtim?
2. Sipas këndvështrimit të bankës suaj, cilat janë sfidat kryesore për sistemin bankar shqiptar, në vazhden e formësimit dhe jetësimit të rimodelimit të ekonomisë kombëtare, në të ardhmen e afërt dhe më tej?



ALPHA BANK ALBANIA
George Papanastasiou
 Drejtor i Përgjithshëm

1 Objektivat tona kryesore për vitin 2019 ishin rritja e qëndrueshme e bankës, optimizimi i raportit të shpenzimeve ndaj të ardhurave dhe i raportit të kostos së riskut, ulja e mëtejshme e raporteve të huave dhe ekspozimeve me probleme, si dhe thjeshtimi i “eksperiencës së klientit” përmes kanaleve tona të shërbimit duke ofruar për klientët tanë, individë dhe biznese, produkte dhe shërbime më të personalizuar, çmime të drejta, procese të thjeshta, dhe mundësi për të përfutuar nga produktet e shërbimit tona në çdo kohë dhe kudo qofshin ata, përmes platformave tona digjitale.

Të gjitha veprimet e ndërmarra kanë të bëjnë me përmirësimin e pozitës dhe ecurisë financiare të bankës. Treguesit kryesorë të ecurisë, të përcaktuar nga Këshilli Drejtues për të gjithë organet e qeverisjes korporative të bankës dhe për të

gjithë punonjësit e drejtuesit tanë, u monitoruan në mënyrë të frytshme. U përmirësua dhe pasurua Sistemi i Kontrollit të Brendshëm, në të gjitha fushat e veprimtarisë tonë bankare. Transaksionet e klientëve u mbështetën nga një sistem operimi bankar i përditësuar: *Flexcube 12.3* dhe *Oracle Banking Digital Experience*, i cili do të përmirësojë ndjeshëm përvojën e klientit, si në degë ashtu dhe në veprimtarinë bankare elektronike. Programi i Garancisë së Kredive COSME do të lehtësojë kreditimin për shumë biznese dhe *Alpha BOT*, asistenti i inteligjencës artificiale përmes faqes sonë në Facebook për 24/7, do të personalizojë komunikimin lidhur me produktet dhe shërbimet.

2 Zhvillimi i sistemit bankar duhet t'i paraprijë, e në të vërtetë i paraprin, zhvillimeve ekonomike në vend.

Së pari, sistemi bankar po mbështet rritjen ekonomike dhe është lojtari e kontribuesi më i rëndësishëm në stabilitetin financiar në vend. Konsolidimi bankar i dy viteve të fundit ka prodhuar një mjedis më konkurrues, i cili i detyron bankat të diferencohen përmes produkteve më konkurruese dhe zgjidhjeve novatore, në mënyrë që të sigurojnë si përvojë të shkëlqyer, ashtu dhe rreziqe të pranueshme.

Së dyti, zhvillimet e sistemit bankar janë në përputhje me nevojat dhe kërkesat e digjitalizimit të ekonomisë. Shumë nisma, që vijnë nga banka të ndryshme dhe nga i gjithë sistemi bankar, do të rrisin efikasitetin e ndërmjetësimit në ekonomi,

përfshirjen financiare dhe mundësinë e përdorimit të shërbimeve dhe produkteve bankare nga një pjesë më e madhe e popullatës. Sidoqoftë, sistemi bankar duhet të jetë gati të përballojë sfidën e çdo transformimi të madh digjital dhe duhet t'i përmbahet praktikave më të mira ndërkombëtare.

Së treti, një treg i shëndetshëm bankar dhe integriteti i tij kërkojnë një reformë të vazhdueshme anti-informalitet dhe një përmirësim të kuadrit ligjor për tregun bankar dhe atë financiar. Autoritetet, bankat dhe institucionet e tjera financiare duhet të punojnë më shumë së bashku për të përmirësuar, jo vetëm kuadrin ligjor, por edhe funksionimin normal të tregut. Kjo do të rrisë besimin e investuesve dhe përdoruesve të fondeve, që do të thotë më shumë fonde për ekonominë reale dhe më shumë vende pune për individët.



**BANKA AMERIKANE
 E INVESTIMEVE**
Andi Ballta
 Drejtor i Përgjithshëm

1 Nejemishumëtë kënaqur me ecurinë e ABI Bank dhe nuk mendojmë se viti 2019 ishte një vit me sfida. Niveli i lartë i likuiditetit dhe mjaftueshmërisë së kapitalit do të vazhdojnë të mbeten një përparësi për ABI Bank. Përthithja e NBG Bank Albania nga ABI Bank përfundoi plotësisht gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 2019. Fushata e huave për banesa dhe disa fushata për produkte specifike kanë riafirmuar pozicionin e ABI Bank në treg.

2 ABI Bank do të përqendrohet në qëndrimin më pranë bazës së zgjeruar të klientelës saj, duke ofruar shërbime të personalizuar dhe duke qëndruar larg segmenteve ku konkurrenca është shumë e fortë. Sfida kryesore e ABI Bank dhe ndoshta e gjithë sistemit bankar, është të mbetet disiplinuar në një fazë kaq të maturuar të tregut, pasi ajo lidhet me çmuarjen dhe kthimin nga rreziku. Ne nuk e përjashtojmë mundësinë e rezultateve mesatare ose modeste për vitet e ardhshme, pasi tregu do të bëhet më konkurrues dhe ne po qëndrojmë larg projekteve që kanë një profil rreziku asimetrik.



TIRANA BANK

Dritan Mustafa

Drejtor i Përgjithshëm

1 Në vlerësimin tim, viti 2019 ri-konfirmon edhe një herë që sektori

bankar shqiptar mbetet sektori më i zhvilluar dhe i mirë-rregulluar në tregun vendas, me ambicie për t'u zhvilluar në kuadër të standardeve të infrastrukturës dhe shërbimit ndaj klientëve. Gjatë vitit 2019 Tirana Bank përfundoi me sukses fazën e tranzicionit, referuar ndryshimit të strukturës aksionare të bankës dhe konsolidimit të strategjisë së biznesit, në periudhën afat-mesme dhe afat-gjatë, në përputhje me vizionin për zhvillim të aksionarëve të rinj.

Banka raporton ndryshime rrënjësore në kuadër të treguesve kryesorë të ecurisë, specifikisht: rritje e totalit të aktiveve dhe e bazës së klientelës, referuar strategjisë për zhvillim; rritje e depozitave të klientëve dhe konsolidim i mëtejshëm i bazës së likuiditetit, që ri-konfirmon besimin e klientëve te banka; rritje të ndjeshme të portofolit të kreditimit, në mbështetje të zhvillimit të ekonomisë vendase dhe nevojave të klientëve, me objektiv të qartë për të vijuar në këtë drejtim edhe gjatë vitit 2020; zvogëlim real, në vëllim dhe përqindje, i portofolit të aktiveve problematike, në vijim të rritjes së cilësisë së kreditimit dhe të masave për rikuperim nga debitorët; rikthimi në rezultate financiare pozitive.

Tirana Bank vijon procesin e transformimit, referuar projektit të modernizimit të infrastrukturës bazë dhe ndihmëse të Teknologjisë së Informacionit, deri në fund të vitit 2020, me objektiv rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj klientëve dhe optimizimin e proceseve dhe praktikave të punës, në përputhje me standardet më të mira bankare.

2 Procesi i konsolidimit të mëtejshëm i sistemit bankar vendas, që vlerësohet se do të vijojë në afat-mesëm, do të krijojë mundësinë për hyrjen në treg të operatorëve të rinj, apo fuqizimin e atyre ekzistues, të cilët kanë vizion të qartë të zhvillimit të tregut. Kjo do të mundësojë një sistem bankar më elastik dhe dinamik, që do të

vijojë të investojë në modernizimin e infrastrukturës së shërbimit dhe të rrisë shkallën e penetrimit me shërbime dhe produkte në tregun vendas.


Zhvillimet e viteve të fundit në ekonominë vendase paraqesin nevojën e rritjes të investimeve të huaja, modernizim të mëtejshëm të infrastrukturës lokale, sikurse edhe një profilizim më të qartë të sektorëve ekonomikë që paraqesin potencial zhvillimi. Proceset e integritimit, në strukturat politike dhe ekonomike të Bashkimit Evropian dhe ato me karakter rajonal, pritet që të ndikojnë në gjallërimin dhe rritjen e mbështetjes të sektorëve specifikë, si: bujqësia, agrobiznesi, turizmi, tregtia e mallrave të konsumit, etj. Këto zhvillime me siguri do të ndikojnë edhe në ri-formatim të sjelljes dhe kërkesës konsumatore në vitet në vijim, duke ndikuar edhe në orientimet specifike të politikave dhe praktikave bankare.

Tirana Bank do të vijojë zhvillimin e mëtejshëm të veprimtarisë, me objektiv të qartë zgjerimin e bazës së klientelës dhe rritjen e mbështetjes financiare, drejtuar individëve dhe bizneseve.

BANKIERI:

1. Një tjetër vit me sfida, si viti 2019, u mbyll për sektorin bankar shqiptar. Si ishte ecuria e bankës suaj, si dhe arritjet dhe zhvillimet kryesore në këtë drejtim?

2. Sipas këndvështrimit të bankës suaj, cilat janë sfidat kryesore për sistemin bankar shqiptar, në vazhden e formësimit dhe jetësimit të rimodelimit të ekonomisë kombëtare, në të ardhmen e afërt dhe më tej?

**UNION BANK****Gazmend Kadriu**

Drejtor i Përgjithshëm

1 Viti 2019 ishte një vit me dinamika, për sa i përket sistemit bankar, ku disa nga ndryshimet e aksionarëve, të iniciuara gjatë 2018-ës, u finalizuan gjatë vitit 2019. Si rrjedhojë e këtij ndryshimi, sot kemi një numër më të reduktuar të bankave në sistem dhe një treg më të konsoliduar dhe të shëndetshëm për konsumatorin shqiptar.

Edhe pse 2019-a në përgjithësi ishte një vit me sfida për ekonominë dhe zhvillimin e vendit, sistemi bankar shqiptar vazhdoi të kryejë detyrën e tij, duke i rezistuar efekteve negative mjedisore dhe duke përforsuar zhvillimet pozitive në krahun e rritjes ekonomike.

Për Union Bank viti 2019 ishte shumë i suksesshëm, duke qenë se u finalizua dhe blerja e ICB Bank. Me këtë blerje ne realizuam dhe objektivin parësor, për të rritur praninë e Union

Bank në treg në numër klientësh, në mbulim gjeografik dhe në nivel aktivesh. Me përthithjen e ICB Bank, Union Bank i afrohet 5% të mbulimit të tregut në hua dhe investime në letra me vlerë dhe rreth 4.5% në totalin e aktiveve dhe në fonde. Banka shkoi në rreth 7% të tregut, për sa i përket numrit total të degëve. Kjo, e kombinuar edhe me rritjen natyrale të fondeve dhe të kreditimit të bankës, mundësuan një ecuri mjaft pozitive rritjeje dyshifrore, sipas parashikimit për vitin 2019, bashkë me një përfitueshmëri po ashtu dyshifrore, në terma të kthimit të kapitalit (ROE).

2 Viti 2020 e gjen sistemin bankar në Shqipëri të konsoliduar, pas disa vitesh në proces ristrukturimi. Ky sistem i qëndrueshëm besoj do të kontribuojë dhe ndikojë pozitivisht në ekonominë e vendit në përgjithësi, duke stimuluar dhe një konkurrencë të shëndetshme, për sa i përket investimeve. Ne si Union Bank synojmë të vijojmë misionin tonë për ekonominë e vendit, duke synuar prirjen e rritjes së nivelit të huadhënies, duke qenë gjithmonë të kujdesshëm në ruajtjen e cilësisë së aktiveve.

Pavarësisht se fillimi i 2020-s ndoshta do të vijë me një de-fokusim, për sa i përket ecurisë së zhvillimeve në vend, për shkak të situatës së krijuar nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, mendoj se nga ana e bankave tregtare angazhimi do të vijojë të jetë maksimal, për të kryer detyrat e tyre sa më mirë karshi klientëve dhe ekonomisë.

**PROCREDIT BANK ALBANIA****Mirsad Haliti**

Anëtar i Drejtorisë Ekzekutive

1 Viti 2019 për bankën ProCredit ka qenë një vit pozitiv, për sa i përket konsolidimit të strategjisë sonë të biznesit për Klientë Privat, ku zhvillimi i konceptit "Direct Banking" ka qenë prioriteti ynë kryesor. ProCredit Bank Shqipëri, si pjesë e grupit Gjerman ProCredit Holding, ka sjellë eksperiencën evropiane në ofrimin e shërbimeve bankare. Për bankën tonë ka rëndësi të veçantë të shërbyerit me përgjegjshmëri dhe kjo realizohet përmes promovimit të kursimit në vend, të shërbimeve që nxisin konsumin, si dhe nëpërmjet ofrimit të shërbimit bankar ekskluziv, që ofron veçori me vlerë për klientët, si: shpejtësia, fleksibiliteti për të menaxhuar 24/7 të gjitha veprimet nga llogaritë e tyre, kursimet, kartat, si dhe mundësia për të përfituar nga financimet me kushte të favorshme. Të gjitha këto veçori realizohen më së miri nga platformat e përparuara elektronike,


si: e-Banking, mobile banking, Zonave 24/7, apo shërbimeve të tjera, që janë pjesë e konceptit të ProCredit Direct. Siç e përmenda dhe më lart, mënyra e drejtpërdrejt e operimit (ProCredit Direct) mundëson që Klientët tanë Privatë të arrijnë të shërbehen përmes kanaleve elektronike në çdo moment, duke u dhënë fleksibilitet për menaxhimin e llogarive të tyre dhe shërbimeve financiare drejtpërdrejt nga kompjuteri, tabletët, apo telefonat e tyre celularë.

Gjithashtu, kemi vazhduar të investojmë në zhvillimin e marrëdhënieve afatgjata me klientët NMV, duke realizuar mbështetjen e investimeve të shumta në sektorë kyç për ekonominë, siç janë: prodhimi, përpunimi, shërbimi si dhe projektet "green". Kemi ruajtur një cilësi shumë të mirë të portofolit të huas, ku kemi arritur të mbajmë një nivel minimal të NPL-së, ndjeshëm nën mesataren e tregut. Tregues pozitiv është rritja e portofolit të investimeve "Green", ku vetëm gjatë vitit të fundit kemi financuar me mbi 12 milionë Euro këto projekte. Portofoli "Green" gjithashtu ka shënuar rritje, duke përbërë 16 % të totalit të portofolit të bankës.

2 Sfidat e kryesore të sistemit bankar shqiptar, në përgjithësi, janë të lidhura ngushtë me ecurinë e ekonomisë së vendit. Bazuar në pritshmëritë mbi rritjen ekonomike të vendit, si dhe në kushtet e një politike monetare lehtësuese, viti 2020 pritet të jetë një vit pozitiv për sistemin bankar. Gjithsesi, ndodhitë e fundit natyrore dhe ndikimi i tyre në ekonomi sigurisht që do ndihet, veçanërisht në zhvillimin e parashikuar nga sektorë të ekonomisë, si: turizmi, apo shërbimi në përgjithësi.

Per sa i përket fokusit strategjik të bankave, rol të rëndësishëm ka fokusimi në sektorë të rëndësishëm të ekonomisë, si: prodhimi apo shërbimi, që kanë dhe potencialin për të siguruar më shumë vende pune dhe ndikim në

ekonominë e vendit tonë. Nga ana tjetër, bankat kanë shtruar para tyre edhe një sfidë shumë domethënëse për të ardhmen: përmirësimi në vazhdimësi i shërbimeve digjitale. Për bankën ProCredit kjo sfidë është në faza të avancuara, për sa kohë që e kemi këtë përjasje që prej vitit 2015, por tani që flasim revolucion digjital në sistemin bankar është fakt, duke shtruar para nesh kërkesa të reja, si: jetësimi i teknologjive më të fundit, me qëllim ofrimin e shërbimit bankar sa më cilësor dhe të shpejtë, nëpërmjet kanaleve digjitale.



FIRST INVESTMENT BANK ALBANIA

Bozhidar Todorov

Drejtor i Përgjithshëm

1 Viti 2019 ishte një tjetër vit pozitiv për Fibank Albania. Veprimtaria e Fibank u rrit me më shumë se 25% në treguesit kryesorë, si: totalin e aktiveve, huave dhe depozitave, duke shënuar ndoshta shkallën më të lartë të rritjes në sistemin bankar shqiptar, e duke kontribuar në rritjen e pjesës së tregut për bankën. Ecuria financiare do të jetë përsëri shumë e mirë e me të njëjtin ritëm si ai i viteve të fundit, duke iu afruar fitimit neto prej 4 milionë eurosh.

Ne hapëm degë të reja, në fillim të vitit 2019, në një kohë kur bankat e tjera

po tkurrnin rrjetin e tyre, si dhe kemi pasur një shtim të stafit me më shumë se 20%, duke treguar përkushtim të fortë për rritjen e biznesit dhe zhvillimet e mëtejshme. Orientimi drejt klientëve përbën fokusin tonë të vazhdueshëm dhe nga një sondazh i rëndësishëm që kryem gjatë vitit (që shkoi), lidhur me Kënaqësinë e Konsumatorëve në rrjetin tonë, nxori një rezultat të shkëlqyer të besnikërisë së klientëve ndaj nesh (Net Promoters Call), duke marrë parasysh edhe praktikatat ndërkombëtare.

2 Përmirësimi i kushteve të të bërit biznes në përgjithësi do t'i ndihmojë bizneset të jenë më konkurruese në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar, e kjo gjithashtu po i ndihmon bankat të ecin përgjithësisht më mirë. Sistemi ynë bankar po vijon të përballet me sfidën e informalitetit, megjithë përpjekjet e qeverisë në këtë drejtim; personalisht mendoj se do të/duhen marrë edhe më shumë masa të tjera, në mënyrë që të zgjidhet një problematikë e tillë. Reforma në drejtësi është një mjet instrument në dorë të qeverisë, që do të ndihmojë të gjithë sistemet të funksionojnë në kushte më të mira dhe të sjellin më shumë prosperitet në vend.

Fibank synon të vijojë prirjen pozitive të ndikimit në mirëqenien e vendit, duke përmirësuar jetën e njerëzve si staf, si klientë dhe si qytetarë. Ne do të vazhdojmë të shfrytëzojmë mundësitë në treg, me përkushtimin tonë për zhvillimin e biznesit, produkteve dhe shërbimeve të reja, në përputhje me kërkesat aktuale dhe të mbështetura nga një ekip profesionistësh shumë i motivuar.

Fitoj interes pa bllokuar fondet ?!



Llogaria e Kursimit FlexSave

#LehtëFare



ProCredit Bank

DIRECT

INTERVISTA

Rimodelimi ekonomik i Shqipërisë: Një përpjekje shumë-planëshe



Anila DENAJ

Ministër

MINISTRIA E FINANCAVE
& EKONOMISË

Viti i ri fiskal sapo ka nisur. Cilat mendoni se janë objektivat madhorë që qeveria synon të përmbushë brenda tij?

Krahas objektivave të programit tonë qeverisës, për të cilat jemi angazhuar për t'izbatuar, viti 2020 do të jetë sfidues, pasi përkon me tejkalimin e pasojave të tërmetit të 26 nëntorit. Për këtë arsye, buxheti i vitit 2020 ka akorduar një fond me vlerë 20 miliardë lekë, tërësisht të dedikuar për rindërtimin e të gjitha zonave të prekura nga tërmeti.

Viti 2020 do të jetë viti i konsolidimit të mëtejshëm të parametrave makro-fiskalë. Në kuadër të reformave të ndërmarra deri më tani, është e domosdoshme të shihet adresimi i politikave në planin afatmesëm, kryesisht në aspektin e politikave fiskale si dhe politikave që vijnë rritjen ekonomike, në një strukturë më të qëndrueshme afatmesme. Rezultatet pozitive të politikave, me fokus rritjen e punësimit, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve, barazinë

gjimore dhe procesin e integritimit në Bashkimin Evropian, janë dhe mbeten në fokus të konsolidimit të vazhduar. Aksesin në arsim cilësor mbetet një prioritet qeveritar, përmes investimeve në infrastrukturën arsimore, ndërtimit dhe rehabilitimit të mbi 180 objekteve arsimore, apo 1,800 - 2,000 klasave dhe laboratorëve mësimorë dhe përmes mbështetjes për studentët, në kuadër të Paktit për Universitetin.

Në sektorin shëndetësor, do të vijojë mbulimi universal me shërbim cilësor shëndetësor, përmes investimeve në infrastrukturën shëndetësore në qendra shëndetësore, maternitete dhe modernizimin e QSUT-s.

Financimi i ngritjes së shërbimeve shoqërore për qytetarët me aftësi të kufizuara dhe familjet në nevojë, si dhe rritja e shkallës së mbulimit me kontributet e pensioneve për qytetarët do të jenë sërish në vëmendje të qeverisë.

Infrastruktura dhe bujqësia mbeten po ashtu sektorë prioritarë, me një fond prej 21 miliardë lek, për projekte rrugore në shërbim të qytetarëve. Në kuadër të zhvillimit rural dhe bujqësor kemi akorduar 3 miliardë lek investime infrastrukturore.

Nisur nga zhvillimet e përgjithshme makroekonomike dhe mikroekonomike, e në një kuadër më të gjerë, në kontekstin e rajonit dhe integritimit evropian, cilat janë pritshmëritë, lidhur me zhvillimin e përgjithshëm ekonomik dhe sa ato konvergojnë me programin e qeverisë?

Integrimi Evropian dhe integrimi rajonal janë dy procese që ecin paralelisht. Katër janë shtyllat kryesore të bashkëpunimit rajonal, të cilat udhëheqin zhvillimet në secilin

vend, siç janë: Tregtia e lirë e mallrave; Integrimi digjital; Mobiliteti dhe Investimet.

Politikat e tregtisë së lirë kanë për objekteliminimin e barrierave tarifore dhe jo-tarifore midis vendeve të rajonit, për lehtësimin e marrëdhënieve. Në nivel kombëtar kjo është e një rëndësie madhore, pasi eliminon procedurat burokratike doganore. Shqipëria prej korrikut 2019 ka përmbyllur projektin: "Dogana pa letra". Ky proces i kursen kohën e biznesit në kalimin kufitar, duke krijuar pika të përbashkëta doganore dhe kufitare, unifikim të dokumenteve tregtarë, njohje reciproke të operatorëve ekonomike të autorizuar dhe një strategji të unifikuar të menaxhimit të rrezikut. Integrimi digjital do të sigurojë roaming falas midis vendeve të Ballkanit Perëndimor, një agjendë të përbashkët digjitale, platformë për njohjen e shërbimeve të besuara (trusted services), përmirësim të sigurisë kibernetike, etj.

Mobiliteti ka për qëllim të sigurojë dhe lehtësojë njohjen reciproke të kualifikimeve akademike, si edhe të garantojë jetësimin e standardeve evropiane, nëpërmjet krijimit të agjencive të garantimit të cilësisë, përafrimit të legjislacionit dhe manualeve të Bashkimit Evropian për profesione të ndryshme.

Agjenda Rajonale e Investimeve, e drejtuar nga reforma rajonale dhe planet individuale të investimeve, synojnë ta kthejnë rajonin në një destinacion unik për investuesit e huaj. Në planet kombëtare, Shqipëria ka përfshirë projektin e Aeroportit të Vlorës. Ndërkohë, vazhdojnë investimet në infrastrukturën rrugore, plani për hekurudhën Durrës – Tiranë – Rinas, si dhe investime të tjera me rëndësi strategjike.

Cilat mendoni se janë sfidat e reja me të cilat do të ballafaqohet ekonomia kombëtare gjatë 2020-ës, e më tej?

Perspektiva e ekonomisë shqiptare në 2020 përballet me sfida, të cilat prej vitit 2019 kanë ndikuar jo pak rajonin dhe vendin tonë. Rritja ekonomike me ritme më të ulëta se parashikimi në vitin e shkuar, tregoi nevojën për një diskutim më të gjerë të trajtimit të platformës për rritjen e investimeve dhe koordinimin e politikave, në sektorët kyç të ekonomisë.

Rritja prej 4.1% e ekonomisë në vitin 2020, pritet të gjenerohet kryesisht nga kërkesa e brendshme, si: konsum dhe investime, por edhe kërkesa e huaj neto. Rritja e mëtejshme e investimeve private, veçanërisht e investimeve të huaja të drejtpërdrejta (IHD) dhe reduktimi i papunësisë janë dy objektiva për të cilat mbetemi optimistë. Sfidë e afërt është ndryshimi strukturor i IHD-ve, duke i orientuar drejt sektorëve prioritarë dhe strategjikë dhe duke sjellë ndikim më të lartë në të ardhura. Vetëm në 9 muajt e parë të 2019-tës IHD-të arritën vlerën e 810 milionë euro dhe papunësia ka vijuar prirjen rënëse, duke arritur nën 11.4%.

Në 2020 në sektorët më të rëndësishëm do të shohim një rritje të punësimit. Pritshmëria afatmesme është reduktimi i papunësisë në një vlerë një shifrore. Sfidë është gjithashtu krijimi i vendeve cilësore të punës dhe zhvillimi i një arsimit cilësor për punët aktuale dhe punët e së ardhmes. Këtu kemi ende punë për të bërë! Gërshtimi i kërkesës dhe ofertës për arsim profesional cilësor nuk mund të bëhet pa input-in e komunitetit të biznesit, që investon në kapitale dhe burime njerëzore, me të njëjtin dimension në vlerë dhe fokus.

Ndryshimi i përfaqësjes aktuale të qytetarëve dhe biznesit në kuadër të zbatimit të nismës së fiskalizimit dhe nxitjet për tërheqjen e kuponit tatimor do të jenë një tjetër proces sfidues. Ky proces pritet të ulë shkallën e

informalitetit, përmes e-faturimit dhe deklarimit në kohë reale.

Emetimi me sukses i Eurobond-it do të jetë themelor për ruajtjen e besueshmërisë së ekonomisë shqiptare në tregjet financiare globale. Ne besojmë që reformat e qeverisë dhe ecuria e projekteve tona madhore sigurojnë stabilitetin e kërkuar nga investuesit.

Angazhimi për procesin e rindërtimit përbën një sfidë, por edhe mundësi për të gjallëruar përsëri zonat e prekura nga tërmeti.

Sa këto sfida shtrojnë nevojën për një rimodelim të ekonomisë kombëtare? Sa e përgatitur është qeveria për të mbështetur, promovuar dhe ndihmuar në rimodelimin e ekonomisë kombëtare?

Taksimi i ndershëm, nxitja dhe orientimi i investimeve private strategjike në sektorët me potencial zhvillimi dhe rritja e kohezionit social janë në vëmendje të Qeverisë për Shqipërinë e dhjetëvjeçarit të ardhshëm.

Rimodelimi i Ekonomisë Kombëtare është një çështje e ngritur për diskutim gjatë vitit 2019, në Këshillin e Investimeve si dhe në Këshillin Konsultativ të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Thelbësore në aspektin ekonomik është ndërthurja e variablave të duhur teknologjikë, fiskalë dhe sektorialë, për të sjellë risi dhe zgjidhje. Ndaj, në vitin që lamë pas, janë ngritur tri grupe teknike, me angazhimin e Ministrive të linjës, akademisë dhe sektorit privat, për të vlerësuar potencialet e zhvillimit të vendit në tri sektorë kryesorë: agro-përpunimi, digjitalizimi dhe energjia.

Rezultatet e punës së ekspertëve do të jenë bazë për mbështetjen dhe promovimin e një modeli, që stimulon ekonominë në sektorë prioritarë, përtej nxitësve fiskalë dhe ndihmon zhvillimin e vendit, në terma afatmesëm dhe afatgjatë.

Një sërë nismash paralele do të jenë kryefjalë e 2020-tës, për zbatimin

e një vizioni, që përfshin çdo qytetar shqiptar, për një treg me rregulla të barabarta e të ndershme dhe për një klimë të favorshme për sipërmarrësit. Prej datës 1 janar 2020 Qeveria ka filluar një revolucion digjital, duke mundësuar kalimin online të 472 shërbimeve, përmes portalit e-Albania. Kjo është vetëm faza e parë e zbatimit të këtij projekti ambicioz, i cili do të përfundojë në fund të 2020-tës.

Një nismë tjetër madhore është ndërhyrja legislative për funksionimin e tregjeve financiare, si një sektor i nevojshëm për të ndjekur ritmin e zhvillimit të rajonit dhe Evropës.

Fiskalizimi, i cili pritet të fillojë zbatimin në vitin 2020, do të sjellë komunikim në kohë reale të bizneseve me administratën tatimore dhe do të shërbejë si instrumenti bazë i përpjekjeve të Qeverisë për një ekonomi plotësisht formale dhe mirë funksionale. Forcimi i biznesit të vogël dhe të mesëm dhe nismat për zhvillimin e kapitalit njerëzor, përmes kurrikulave të arsimit profesional, mbeten gjithashtu në qendër të vëmendjes tonë.

Në këtë formë, shtrojmë udhën për një rimodelim ekonomik të vendit; shërbejmë si katalizatorë për një rritje të vazhdueshme dhe krijojmë një kuadër orientues, si instrument për një sektor privat që mobilizon investime, sjell punësim dhe zhvillim të qëndrueshëm. Megjithatë, koordinimi në kohë i masave për një efektivitet në rritje dhe kuptueshmëria e reformave, së pari nga biznesi, janë sfida shoqëruese të planeve afatmesme. Komunikimi me grupet e interesit është në fokus, por asnjëherë i mjaftueshëm. Ridimensionimi i një komunikimi efektiv dhe vizionar i masave dhe reformave, për një plan dhe analizë të plotë të përfitimeve dhe kostove, duhet të jetë në fokus për të nxitur përpara projekte që çojnë përpara zhvillimin ekonomik dhe zgjidhin shumë probleme, edhe të vjetra, të ekonomisë shqiptare.

Modeli i ri ekonomik për Shqipërinë

Nevoja për kapital njerëzor të kualifikuar dhe infrastrukturë teknologjike

Ka ardhur koha që arsimit dhe kualifikimi i forcës punëtore të vendosen në listën e parë të prioriteteve të vendit. Gjithashtu, modeli i rritjes ekonomike të fortë në afatin e gjatë kërkon vëmendje të veçantë në përmirësimin e mëtejshëm të infrastrukturës “tradicionale”, ashtu dhe të infrastrukturës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.



Prof. Dr. Luljeta MINXHOZI

Zv. Guvernatore e Parë
BANKA E SHQIPËRISË¹

Ngadalësimi i ekonomisë botërore dhe efektet saj në Eurozonë, si dhe në rajonin e Ballkanit, kanë ndikime të dukshme edhe në ekonominë shqiptare, duke sjellë në vëmendje përsëri diskutimet rreth modelit të rritjes ekonomike. Megjithatë gjatë viteve të fundit Shqipëria ka përjetuar norma në rritje të ecurisë të PPB-së për thujse një dhjetëvjeçar, zhvillimi ciklik e vendos ekonominë shqiptare përpara dinamikave të reja, duke e përballur me situata me ritme më të moderuara të rritjes ekonomike.

Raportet ekonomike tregojnë se, investimet e huaja, shumë

të rëndësishme për zhvillimin ekonomik të vendeve të rajonit tonë, vazhdojnë të mbeten përgjithësisht të kënaqshme, pavarësisht rritjes së ulët ekonomike në Eurozonë. Megjithatë, veprimtaria e lëkundur ekonomike në Eurozonë dhe më gjerë, mund të ulë entuziazmin për investimet e huaja greenfield në të ardhmen. Tërheqja e



Kufizimet më të mëdha për rritjen e mëtejshme të ekonomisë shqiptare duket se do të vijnë nga pamjaftueshmëria e kapitalit njerëzor dhe mungesa e një infrastrukture më të sofistikuar. Pritshmëritë për një tkurrje të ndjeshme demografike në një të ardhme jo të largët ngrenë shumë pikëpyetje mbi mundësitë e rritjes ekonomike.



investimeve të huaja dhe rritja ekonomike në të ardhmen do të varet nga aftësia e ekonomive për të zvogëluar hendekun e krijuar. Prandaj, prioritizimi i “faktorëve plotësues të prodhimit” është i domosdoshëm për mbështetjen e

rritjes së shpejtë ekonomike.

Vlerësimet për vitet e ardhshme të ekonomisë shqiptare sugjerojnë se, veprimtaria ekonomike do të vijojë të mbështetet nga rritja e kërkesës së brendshme, në mënyrë të veçantë nga zgjerimi i konsumit privat dhe investimeve private. Kjo prirje është mjaft e ngjashme edhe me sjelljen ekonomike të vendeve të tjera të rajonit, të cilat po ashtu e mbështesin rritjen e tyre ekonomike në rritjen e shpenzimeve konsumatore dhe të investimeve. Karakteristika themelore e dinamikës së ekonomisë shqiptare është se ajo është duke operuar në kushtet e një inflacioni të ulët, i cili shkaktohet si nga pamjaftueshmëria e presioneve inflacioniste të sektorëve të brendshëm, ashtu edhe nga dobësia e inflacionit të importuar.

Zhvillimet Financiare

Në dallim nga dinamika e moderuar e sektorit real, tregjet financiare në Shqipëri kanë qenë të qeta dhe kanë dëshmuar për prime të ulëta rreziku. Kostot e ulëta të financimit të bankave, por edhe rritja e konkurrencës në tregun bankar, kanë krijuar kushte mjaft pozitive për rënien e mëtejshme të normave të interesit për kreditë, si për bizneset ashtu

¹ Mendimet e shprehura në artikull janë të autores dhe nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

dhe për individët. Në këto kushte, zhvillimet pozitive në tregjet financiare përbëjnë një mundësi të mirë të financimit të rritjes ekonomike në të ardhmen.

Përveç prirjeve globale dhe perspektivës ekonomike rajonale, transformimi që po ndodh në sektorin financiar përbën një tjetër sfidë, që ka të bëjë me ristrukturimet e bankave në rajon, evoluimin e kuadrit rregullator të sistemit financiar, si dhe inovacionet teknologjike, sidomos me mjetet e pagesave. Të gjitha këto sfida kanë pasoja të qenësishme për rregullimin dhe mbikëqyrjen e sistemit financiar, me qëllim rritjen e eficiencës së tregut dhe përmirësimin e efektshmërisë së politikave të bankës qendrore.

Përgjithësisht, të dhënat më të fundit të Bankës së Shqipërisë tregojnë se, sektori bankar paraqitet i shëndetshëm. Ekspozimi i sistemit financiar ndaj rreziqeve të tregut, të likuiditetit, dhe të kapitalizimit shfaqet në nivel të kufizuar dhe me rezistencë të mirë. Duhet të theksohet se, është shumë inkurajues fakti që, kredia me probleme është reduktuar ndjeshëm, falë shlyerjeve, fshirjeve të kredive të humbura dhe sigurisht masave të marra për ristrukturimin e kredive.

Sot, aktivet likuide shfaqen në nivele mjaft më të larta se sa raportet minimale, të kërkuara nga kuadri rregullator i Bankës së Shqipërisë. Megjithatë, rritja e depozitave bankare në monedhë të huaj mund të shihet si shqetësim. Ky zhvillim pasqyron praninë e gjerë të valutës në ekonomi, e cila ndër të tjera përbën rreziqe të caktuara për stabilitetin financiar. Për këtë shkak, veprimet konkrete të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë në zbatim të Memorandumit Ndërinstitucional

për Fuqizimin e Përdorimit të Monedhës Vendase, me qëllim uljen e përdorimit të valutës në ekonomi, janë për t'u vlerësuar.

Si pasojë e këtyre zhvillimeve, kreditimi i sektorit privat ka vijuar të përmirësohet, duke shënuar një rrije prej 7.5 për qind në tremujorin e tretë të vitit 2019. Rritja e kërkesës për kreditim në sektorin privat është mbështetur edhe nga zhvillime pozitive në tregun e punës dhe në tregues pozitivë të besimit të biznesit. Një



Ekonomisë kombëtare i nevojitet një rritje e produktivitetit, përmes investimeve dhe adoptimit të teknologjisë, që mund të nxisë konvergjencën me Evropën Perëndimore, të ndihmojë në zvogëlimin e hendekut të pagave, e për rrjedhojë, të frenojë flukset e emigrimit.



tregues tjetër i qëndrueshmërisë është edhe rigjallërimi i financimit në monedhën vendase. Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2019 kredia në lekë u zgjerua me 9.4 miliardë lekë, ose dy herë më shumë se rrija mesatare e dy tremujorëve të kaluar.

Kriza financiare globale i ka shtyrë vendet e zhvilluara të tregojnë gjithnjë e më pak të interes për të ruajtur investimet jashtë vendit. Ky ristrukturim i tyre kërkon një administrim të kujdesshëm. Sido që të shkojë përjta e strategjisë së tërheqjes së vendeve të zhvilluara, institucionet tona nuk duhet të ndikohen, për sa i përket angazhimeve për liberalizimin e

tregut të shërbimeve financiare, dhe në nismat e ndërmarra për forcimin e koordinimit të kuadrit rregullator dhe mbikëqyrjes. Banka e Shqipërisë, do të vazhdojë politikën monetare stimuluese nëpërmjet uljes së kostove të financimit dhe rritjes së kredisë. Stimuli monetar do të transmetohet nëpërmjet nivelit të ulët të normës së interesit dhe injektimit të vazhdueshëm të likuiditetit në tregun ndër-bankar.

Sfidat

Nga të gjitha vlerësimet del se ngadalësimi i ekonomisë shqiptare është ndikuar më së shumti nga faktorë të ofertës agregate. Për më tepër, kufizimet më të mëdha për rritjen e mëtejshme të ekonomisë shqiptare duket se do të vijnë nga pamjaftueshmëria e kapitalit njerëzor dhe mungesa e një infrastrukture më të sofistikuar. Pritshmëritë për një tkurrje të ndjeshme demografike në një të ardhme jo të largët ngrënë shumë pikëpyetje mbi mundësitë e rritjes ekonomike. Për këtë, nevojitet një rritje e produktivitetit, përmes investimeve dhe adoptimit të teknologjisë, që mund të nxisë konvergjencën me Evropën Perëndimore, të ndihmojë në zvogëlimin e hendekut të pagave, e për rrjedhojë, të frenojë flukset e emigrimit. Por kjo varet shumë nga gjendja e kapitalit të duhur njerëzor, i cili krijohet nëpërmjet arsimit dhe aftësive profesionale.

Ka ardhur koha që arsimit dhe kualifikimi i forcës punëtore të vendosen në listën e parë të prioritetëve të vendit. Gjithashtu, modeli i rritjes ekonomike të fortë në afatin e gjatë kërkon vëmendje të veçantë në përmirësimin e mëtejshëm të infrastrukturës "tradicionale", ashtu dhe të infrastrukturës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

Sistemi bankar në Bosnjë Hercegovinë

I angazhuar në një proces të përhershëm rritjeje

Ne duhet të jemi të vetëdijshëm se e ardhmja varet, kryesisht, nga ajo që bëjmë sot - tani. Pa përpjekjet e sotme të vazhdueshme dhe racionale, e ardhmja mund të mbetet thjesht një ëndërr e perealizuar.



Berislav KUTLE

Drejtor
SHOQATA E BANKAVE TË BOSNJË
HERCEGOVINËS

Në Shoqatën e Bankave të Bosnjë - Hercegovinës aderojnë të gjitha bankat që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në vend. Nëpërmjet grupeve të punës, kryesisht Bordit Drejtues, ajo e konsideron detyrim, të drejtë dhe përgjegjësi të saj të publikojë për herë të parë Librin e Bardhë, nën kujdesin e Bordit Drejtues të Shoqatës së Bankave, me pjesëmarrjen aktive të të gjithë përfaqësuesve të bankave, në respekt maksimal të klientëve dhe gjithë komunitetit shoqëror të Bosnjë - Hercegovinës (B-H).

Zhvillimi i bankingut modern në B - H filloi njëkohësisht me krijimin e Bosnjë - Hercegovinës, si shtet i pavarur dhe i njohur ndërkombëtarisht. Fundi i luftës (1992-1995) shënoi fillimin e rivendosjes dhe ndërtimit të të gjithë elementëve themelorë të shtetit, përfshirë këtu dhe institucionet financiare, veçanërisht në fushën e bankingut: Bankën Qendrore të B - H,

bankat dhe agjencitë e tyre, Agjencinë e Sigurimit të Depozitave, si dhe institucionet e tjera financiare. Në vitet e para pas luftës nuk u shënuar asgjë e veçantë lidhur me zhvillimin e bankave, përveç dëshirës, gatishmërisë dhe krijimit të një pjese të vizionit. Në vend mungonin dijet e kohës, stafi cilësor, fondet, infrastruktura organizative dhe materiale, klientët e mëdhenj e të besueshëm, legjislacioni i përshtatshëm, etj. Ndiha nga institucionet ndërkombëtare ishte me rëndësi jetike dhe një katalizator i vërtetë në ndërtimin e sistemit të sotëm bankar në Bosnjë - Hercegovinë. Bankingu ka përshkuar një rrugë të mundimshme, të vështirë, - por më e rëndësishme - të suksesshme. Aktualisht, ai përbën pjesën më moderne të ekonomisë dhe shoqërisë së Bosnjë - Hercegovinës. Sot ne kemi një legjislacion modern në rrafsh evropian dhe botëror, thelbësisht të përafuar me Bashkimin Evropian. Për shkak të cilësisë së punës, operacioneve dhe produkteve të tyre, bankat janë në gjendje të ofrojnë shërbime cilësore për klientët e tyre.

Posi renditet Bosnjë - Hercegovina, sipas kriterëve të institucioneve ndërkombëtare? Në Raportin e Konkurrueshmërisë Globale për vitin 2018, Forumi Ekonomik Botëror i

Davosit e rendit B - H në vendin e 91-të, nga 140 vende gjithsej. Në mesin e vitit 2019, vlerësimi i besueshmërisë për B - H, sipas Standard & Poors, ishte B me perspektivë pozitive dhe B3 me perspektivë të qëndrueshme, sipas Moody's. Nëse kushtet politike në B - H nuk ndryshojnë në mënyrë thelbësore, ka arsye të forta për uljen e këtij vlerësimi, i cili do të ndikojë gjithashtu edhe në sektorin bankar. Të gjithë parametrat makroekonomikë në B - H janë në një nivel absolutisht të ulët: PBB-ja nominale, eksportet, importet, raporti eksport-import, borxhi i jashtëm dhe i brendshëm, shkalla e papunësisë, shkalla e rritjes së prodhimit industrial, politika monetare e bazuar në bordin e monedhave, kompleksiteti i sistemit fiskal, vëllimi i investimeve të huaja të drejtpërdrejta, etj.

E rëndësishme është të theksohet se secila përqindje e rritjes mbi një bazë të ulët nuk sjell arritje pozitive domethënëse. Një arritje pozitive kërkon të paktën ritme të rritjes dyshifrore, krahasuar me ato aktuale. Paqëndrueshmëria politike në vend, ngadalëson gjithashtu mundësitë e rritjes dhe ndryshimeve, të cilat janë parakusht për reforma madhore.

Sektori bankar i B - H karakterizohet nga një përqendrim i lartë, ku

Gjendja dhe parashikimet e treguesve makroekonomikë, në periudhën 2017-2022:

Treguesi/Viti	2017	2018	2019p	2020p	2021p	2022p
PBB nominale (mld BAM)	31,3	31,8	33,6	36,5	38,6	40,9
PBB nominale (mld EUR)	16,0	16,3	17,2	18,6	19,7	20,9
PBB për frymë (EUR)	4.090	4.272	4.507	4.906	5.188	5.503
PBB reale (ritija vjetore %)	3,0	3,2	3,4	3,7	3,9	4,0
ICK (mesatare vjetore %)	1,4	1,5	2,1	1,7	1,8	2,0
Bilanci tregtar (% të PBB-së)	- 23,9	- 26,0	- 26,3	- 23,8	- 23,2	- 22,8
IHD (% e PBB-së)	2,0	2,4	2,5	2,5	2,7	2,9
Borxhi publik (% e PBB-së) vlerësim FMN	45,6	43,4	40,7	37,4	36,9	35,7
Total i huas për sektorin privat (ritija v/v%)	7,3	6,3	6,8	7,0	7,8	7,9

Mos i kurseni
dëshirat

Kredi Personale

ME KREDINË PERSONALE PËRFITONI TË GJITHË

- Zgjidheni vetë këstin e kredisë
- Aprovim i shpejtë
- Deri në 2.000.000 lekë pa kolateral

www.raiffeisen.al



**Raiffeisen
BANK**

mbizotërojnë katër banka/grupe, që zotërojnë gati gjysmën e aktiveve të sektorit bankar (UniCredit Group, Raiffeisen Bank, Intesa Sanpaolo Bank dhe NLB Group). Gjendja në sektorin bankar po përmirësohet vit pas viti. Vetë-qëndrueshmëria, siguria dhe përfitimi i bankave janë në nivele të kënaqshme. Niveli i huave me probleme duhet të shihet në dy mënyra të ndryshme. Nëse krahasohet me vendet e tjera të rajonit, ai është ndër më të lartat. Nga ana tjetër, nëse shikohet duke marrë parasysh realitetin e tregut të B – H ku bankat bëjnë biznes, ai është i ulët dhe mbulimi i tij me rezerva është i kënaqshëm. Kjo do të thotë që bankat i menaxhojnë mirë rreziqet, në kushtet aktuale të B – H. Por rregullimi dhe mbikëqyrja e operacioneve bankare nga organet përkatëse ka një rëndësi të veçantë. Legjislacioni, i përafëruar me normat bashkëkohore evropiane, duhet të jetë një faktor shtesë sigurie. Praktikrat dhe parimet e biznesit bankar në Bashkimin Evropian janë të pranishme edhe në tregun e B – H, përmes grupeve të mëdha bankare që ushtrojnë veprimtari këtu dhe që kanë një pjesë dominuese të tregut.

Konkurrenca në sektorin bankar në B – H është jashtëzakonisht e lartë. Oferta e produkteve bankare është dukshëm më e madhe se kërkesa, jo sepse sektori bankar është i madh, përkundrazi, shkalla e zhvillimit ekonomik të B – H është relativisht e vogël, në krahasim me aktivitet bankare, që janë shumë të mëdha për të. Gjatë viteve të ardhshme mund të pritet një numër më i vogël bankash, duke iu përshtatur më shpejt kushteve të reja të tregut. Digjitalizimi, hyrja e aktorëve të rinj të mëdhenj në treg, ulja e interesave të huas, rritja e normës pasive të interesit dhe shumë rreziqe të tjera, deri më tani të panjohur por të sigurt, janë pjesë e asaj që bankat do të duhet të marrin parasysh në të ardhmen e afërt. Në një mjedis të globalizuar, industria bankare e B – H

është, gjithashtu, pjesë e tronditjeve në të gjithë botën.

Menaxhimi i ndryshimit nënkupton një kornizë të plotë të të gjitha veprimtarive të nevojshme, për të sjellë ndryshime pozitive. Në menaxhime "zinxhirin" e misionit tonë në tregun bashkëkohor, me "hallkat" e mëposhtme: vizioni + strategjia + aftësia + stimujt + burimet + planin e veprimit = ndryshimi pozitiv. Për secilën hallkë të menaxhimit të ndryshimit, ne kërkojmë vazhdimisht përgjigje për pyetjet e mëposhtme:

A është vizioni i ri i mjaftueshëm për të frymëzuar veprimin e partnerëve të sotëm dhe të rinj dhe palëve të interesuara? Pa një vizion të qartë do të kemi konfuzion!

Cila është strategjia? Pozicionimi strategjik nënkupton kryerjen e veprimtarive ndryshe nga rivalët që kryejnë veprimtari të ngjashme, në mënyra të ndryshme (më të mira).

Cilat aftësi duhet të forcohen te stafi dhe ekipi drejtues, për të arritur ndryshimet? Pa aftësitë e nevojshme do të përjetojmë ankth.

Çfarë stimuluesh dhe treguesish duhet të jenë aplikohen, për të arritur çdo qëllim? Mungesa e stimuljeve krijon rezistencë.

Çfarë burimesh mungojnë dhe si mund të rriten burimet shtesë, ose të arrihet qëndrueshmëria? Pa burime përjetojmë shtrëngesa.

A siguron plani i veprimit që po zhvillojmë një hartë të qartë rruge për 3 - 5 - 10 vitet e ardhshme?

A do jemi në gjendje ta ndjekim këtë plan veprimi pa pengesa? Pa një plan të qartë veprimi ndoshta do të kemi një fillim të gabuar.

Kjo pasohet nga pyetjet e mëposhtme, të cilat kërkojnë përgjigje

të qarta:

- Cilat nevoja po zgjidhim sot për klientët tanë? A ia vlen ende të zgjidhen?
- Cilat janë frikërat tona më të mëdha për të ardhmen?
- Cilat prirje besojmë se do të ndikojnë në veprimtarinë tonë?
- Cila është përparësia jonë, për sa i përket këtyre prirjeve?
- Cilat janë mundësitë që paraqesin secila prirje?
- Cilat kërcënime lidhen me secilën prirje?
- Si do të duket biznesi ynë në 3 - 5 vjet; a i shfrytëzon ai plotësisht përparësitë e kësaj prirje?
- Cilat hapa duhet të ndërmarrim, për të filluar në drejtimin dhe në rrjedhën e duhur, sot?

Ne nuk duhet të humbasim vëmendjen nga misioni ynë themelor, të udhëhequr nga dëshira për një rritje dhe fitim sa më të madh të mundshëm. Armiku më i madh i zhvillimit strategjik – përmbushja e vizionit – është dëshira e madhe për rritje të shpejtë afatshkurtër. Çdo ndryshim që duam të arrijmë duhet të jetë evolucionar dhe jo revolucionar. Ne duhet të jemi të vetëdijshëm se e ardhmja varet kryesisht nga ajo që bëjmë sot - tani. Pa përpjekjet e sotme të vazhdueshme dhe racionale, e ardhmja mund të mbetet thjesht një ëndërr e përealizuar. Do të ishte katastrofike të imagjinojmë dhe ëndërrojmë të ardhmen, pa e ndërtuar dhe arritur atë tani, në mënyrë aktive dhe kuptimplotë. Kjo është një nga arsyet themelore pse Shoqata e Bankave të Bosnjë Hercegovinës përgatiti dhe botoi Librin e Bardhë.

	2013	2014	2015	2016	2017	2018	Të dhënat më të fundit	2019e
Indikatorët e sektorit bankar								
Totali i Aktiveve (mld Eur)	11.8	12.3	12.8	13.3	14.4	15.8	15.9	16.6
Totali i Aktiveve (në % të PBB-së)	86.1	87.9	87.3	87.3	90.0	94.1	89.3	93.3
Totali i Huave (mld Eur)	8.2	8.4	8.6	8.8	9.3	10.0	10.0	10.5
Totali i Depozitave (mld Eur)	7.3	7.9	8.5	9.1	10.1	11.1	11.2	12.0
Non-performing Loans (%) - NPL	15.1	14.2	13.7	11.8	10.0	9.4	n.a	9.1
Kthimi nga Aktivitet (%) - ROA	-0.1	0.8	0.3	1.1	1.5	1.5	n.a	1.5
Kthimi nga Kapitali i Vet (%) - ROE	-0.5	5.4	2.0	7.3	10.3	11.1	n.a	10.5

Kolaterale alternative

Një mundësi më shumë për zgjerimin e huadhënies

Mungesa e një shërbimi të mirëfilltë të menaxhimit të kolateralit, pengon konsiderimin e pengut të inventarit si kolateral i mirëfilltë.



Admira Llazari (Mlika)

Drejtuuese, Departamenti i Riskut të Kredisë
BANKA KOMBËTARE TREGTARE

Në çdo ekonomi në zhvillim, huadhënia ka një rëndësi dhe rol të jashtëzakonshëm për zhvillimin dhe rritjen e kapaciteteve të saj. Në Shqipëri sektori bankar modern shënon pothuaj 28 vite nga krijimi i tij dhe aktualisht ai mbetet sektori më i rëndësishëm i sistemit financiar në Shqipëri, aktivet e së cilit zënë rreth 90% të tij, duke nënkuptuar njëkohësisht edhe rolin e dobët, ose jo-ekzistent të tregut të kapitaleve.

Por si ka evoluar kreditimi në këtë sistem i cili mund të quhet relativisht i ri?

Zhvillimet në ekonominë globale dhe veçanërisht kriza ekonomike botërore e 2008-s ushtruan një ndikim negativ mbi tregun shqiptar, tkurrjen e tregut të huave, duke e ngadalësuar atë në mënyrë progresive. Megjithatë, krahas sfidave të shumta, për vitin 2019

Shqipëria renditet ndër tregjet me ritmet më të larta të rritjes në Ballkanin Perëndimor dhe Europën Qendrore & Juglindore. Sipas Bankës së Shqipërisë, në T3 të 2019-ës portofoli i huas shënoi një rritje mesatare prej 6%, nga te cilat huaja për sektorin privat 7.5%, dukshëm më e lartë se rritja mesatare për Ballkanin Perëndimor dhe Europën Qendrore & Juglindore. Kjo prirje, ndër të tjera, shpjegohet nga disa faktorë, si: përfundimi i procesit të shitblerjes së bankave dhe hyrja në treg e investuesve të rinj, që ka ndikuar në një përjasje më favorizuese ndaj bizneseve dhe ka nxitur konkurrencën bankare; ristrukturimet apo fshirjet e huave të humbura; planet e investimit dhe kërkesat ekonomisht të pranueshme nga ana e bizneseve; si dhe vijueshmëria e normave të ulëta historike të interesit. Megjithatë, raporti i huave mbi depozitat shënon 49.2% (dhjetor 2018) dhe bankat në Shqipëri ende vijojnë të konsiderojnë si një ndër elementet thelbësorë gjatë analizës dhe aprovimit të një financimi, ofrimin e një garancie pasurore (kolateral) në favor të tyre, në një raport të caktuar me shumën e kredisë.

Garancia pasurore renditet e 3-ta në radhën e faktorëve për t'u analizuar gjatë huadhënies: 5 K-të, (Karakterit, Kapaciteti financiar, Kolaterali, Kapitali dhe Kushtet), ku secili prej faktorëve kanë ndikimin e tyre në vendimmarrje. Pa diskutuar peshën në vlerësim që ka karakteri, besueshmëria dhe aftësia paguese e huamarrësit, arsyeja kryesore

pse bankat marrin garanci pasurore (kolateral) është ulja e rrezikut të kredisë, veçanërisht në rast të mospagimit të borxhit, krizave të ndryshme dhe dështimit në realizimin e fondeve të pritshme nga huamarrësit. Nga ana tjetër, kolaterali është një teknike zbutëse e ekspozimit ndaj humbjes nga huat dhe i lejon bankat të rrisin portofolet e tyre, arritur nivelet e duhura të mjaftueshmërisë së kapitalit si dhe ofruar çmim më të mirë në treg për huat.

Nevoja për mbrojtje ndaj rrezikut të kredisë bëhet më domethënëse në një mjedis ku raporti i huave me probleme është relativisht i lartë. Në sektorin bankar shqiptar, në varësi të politikave të secilës bankë, kërkesa për mbulim me kolateral varion nga 100% - 150%. Sipas Bankës së Shqipërisë, në dhjetor 2018, pjesa më e madhe e portofolit të huave (78.2%) është e kolateralizuar. Referuar llojit të kolateralit, pjesa më e madhe e huave, rreth 53%, është e kolateralizuar me pasuri të paluajtshme. Huat për individët kanë një nivel më të lartë mbulimi me pasuri të paluajtshme, me 63%, krahasuar me huat për bizneset, që janë 48%. Prirja e sektorit bankar në këtë drejtim lidhet kryesisht me:

- pasigurinë e situatës financiare të bizneseve tregtare, parashikimeve e analizave që bëjnë bankat për aftësinë paguese të huamarrësit, në një mjedis ku ekonomia cash ende zë një peshë të konsiderueshme të veprimtarisë ekonomike;

- problematikat që karakterizojnë sektorin ku zhvillon veprimtari subjekti;
- planin e investimit dhe logjikën/përfitueshmërinë ekonomike të tij;
- situatën e përgjithshme politike dhe makroekonomike, që ka shoqëruar vendin në këto vite.

Sa më lart, megjithë rënien e huave me probleme në nivelin 10.6 %, në fund të T3 të 2019-ës, kërkesat për kolateral, në raport me shumën e huas, vijojnë të mbeten të shtrënguara. Megjithatë, ekzekutimi i kolateraleve nuk është një proces aspak i lehtë, përkundrazi, një rrugë plot pengesa të natyrës ligjore, shoqëruar nga burokracitë dhe rastet korruptive në instanca të ndryshme, problematika të dokumentacionit ligjor të pronës apo shitshmërisë së saj në treg dhe më madhorët: faktorit njerëzor dhe ndikimit social e shoqëror. Administrimi i huave me probleme i ka përballur bankat me një numër relativisht të lartë ekzekutimesh dhe marrjes së kolateraleve në pronësi në përfundim të këtij procesi. Shitja e kolateraleve të llojit: apartament, shtëpi banimi, apo njësi tregtare (dyqan), është relativisht më e suksesshme se sa e fabrikave, magazinave, tokave bujqësore apo linjave të prodhimit, ku shitja është thuajse e pamundur. Ndikimi negativ i mbajtjes së kolateraleve në bilancet e bankave, nga pikëpamja e stabilitetit financiar, por edhe në kuadër të një trysnie të mundshme për rënien e çmimeve në treg, i largon bankat nga misioni kryesor i huadhënies dhe i nxit ato të investojnë jo pak në administrimin dhe shitjen e pronave të ekzekutuara.

Përballë këtyre sfidave, nevojitet eksplorimi i llojeve dhe alternativave të tjera që mund të konsiderohen

si garanci për shlyerjen e huave, apo mjete alternative të financimit. Ndryshe nga vendet e rajonit, si: Greqia, Serbia, Mali i Zi, apo Maqedonia e Veriut, ku tregu i kapitaleve është i organizuar dhe funksional, mungesa e një tregu të tillë dhe mos funksionimi ende i një burse letrash me vlerë, nënkupton pamundësi për tregtim të aksioneve në bursë apo emetimin e titujve të borxhit nga shoqëritë shqiptare. Organizimi dhe funksionimi i një tregu të konsoliduar letrash me vlerë, jo vetëm ul informalitetin, rrit transparencën në publik dhe certifikimin e pasqyrave financiare nga kompanitë audituese, por u mundëson shoqërive të listuara një mekanizëm efikas për sigurim të fondeve të nevojshme, për financimin e projekteve dhe investimeve afatgjata.

Nëpërgjithësi, mbështetja etepërt në huadhënien kundrejt kolateralit është e dëmshme për kredimarrësit, kredihënësit dhe ekonominë në përgjithësi, pasi burimet e kolateralit janë gjithashtu të kufizuara. Ngritja e Byrosë së Kredive, si ndërmjetëse e informacionit, një projekt aktualisht në zhvillim e sipër, do të ofronte një sërë përfitimesh për kreditorin dhe aplikantin. Vlerësimi i plotë i historikut dhe qasjes ndaj pagesave të kredimarrësve, do t'u mundësonte këtyre të fundit kredi të pa-kolateralizuara, apo lehtësonte kërkesën për kolateral.

Marrëveshjet e shkëmbimit CDS¹.

CDS është një instrument që ofron mbrojtje nga rreziku i humbjes së huas, përmes transferimit të rrezikut të humbjes së saj nga banka në një institucion tjetër të specializuar në shitjen e këtij produkti, të tilla si shoqëritë e sigurimit. Në këtë rast, shoqëria e sigurimit, kundrejt një

primi të caktuar, do merrte përsipër të paguante bankën mbi shumën e plotë, ose të pjesshme të huas se siguruar, nëse shoqëria përkatëse dështon në shlyerjen e detyrimit kontraktual ndaj bankës. CDS-të diversifikojnë rrezikun e huas dhe rrisin kapacitetin huadhënës në sistemin financiar, por nisur nga eksperiencia e krizave të shkuara, është e qartë që tregje të tilla kërkojnë sisteme ligjore dhe rregullatore mjaft strikte dhe të mirë-strukturuara.

Alternativa më të thjeshta kolaterali do të ishin pengu i inventarit, aksionet e kapitalit, metaleve dhe mallrave, letër garancive dhe letër kreditë, që megjithëse formalisht ekzistojnë, përdorimi i tyre i gjerë dikton nevojën jo vetëm të ekzekutimit efikas të tyre, por dhe të një qasjeje bashkëpunuese ndërmjet lëshuesit të garancisë dhe përfituesit fundor të saj. Nga ana tjetër, mungesa e një shërbimi të mirëfilltë të menaxhimit të kolateralit, pengon konsiderimin e pengut të inventarit si kolateral i mirëfilltë. Për shembull: pengu i llogarive të arkëtueshme nga tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH), është një mjet mjaft efektiv për nxitjen e huadhënies, që gjithashtu kërkon rregullime dhe përqasje ligjore, për të krijuar sigurinë dhe mbrojtjen e të drejtave të huadhënësit mbi këtë kolateral.

Së fundi, përafrimi i kuadrit rregullativ me Bazel III, një proces i vazhdueshëm me fokus kryesisht te aktet që lidhen me treguesit e likuiditetit, mjaftueshmërisë së kapitalit, ekspozimet e mëdha dhe provat e rezistencës për bankat, shfaqin ndër të tjera ndikimin e kolateralit në përllogaritjen e treguesve të mësipërm dhe ndikimin e tij në kapacitetin huadhënës të bankave.

¹ Policë mbrojtëse e sigurimit kundrejt moskthimit të huave – Credit Default Swap.

Kur ndryshimet ligjore kalojnë pa proces konsultimi

Dispozitat e ligjit të ri “Për shërbimin përbarimor gjyqësor privat” dëmtojnë interesin e përgjithshëm të të gjithë kreditorëve dhe debitorëve dhe krijojnë një konflikt të pastër interesi me funksionin parësor të përbaruesit e, në terma të përgjithshëm, shkon kundër të drejtës kushtetuese të lirisë në krijimin e një veprimtarie ekonomike.



Brunilda KOSTARE

Këshilltare ligjore
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Në datën 8 maj 2019 Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin 26/2019: “Për shërbimin përbarimor gjyqësor privat”. Sektori bankar, si palë e interesuar, u përfshi, midis palëve të tjera të interesuara, në diskutimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10031, datë 11.12.2008: “Për shërbimin e përbarimit privat”, me Komisionin Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut. Propozimet për ndryshime të diskutuara jo vetëm që nuk u morën në konsideratë, por pa ndonjë diskutim/konsultim paraprak, në mungesë të plotë të transparencës, në seancën parlamentare të 8 majit 2019 u paraqit për votim një projektligj i ri, që përmbante dispozita të rëndësishme, që nuk u prezantuan

kurrë me projektligjin që do të ndryshonte ligjin aktual në fuqi në atë kohë, e për këtë arsye, dispozita të tilla nuk u diskutuan kurrë me grupet e interesuara, madje as në komisionet parlamentare.

Me gjithë përmirësimet që mund të ketë sjellë ligji 26/2019, në organizimin, funksionimin dhe kontrollin e shërbimit përbarimor gjyqësor privat, dispozitat që parashikojnë, që përbaruesi gjyqësor privat të ushtrojë si veprimtari dytësore “njoftimin e debitorëve dhe mbledhjen e detyrimit financiar me mirëkuptim të ndërsjellë”, është një element plotësisht i ri, i cili nuk u prezantua kurrë më parë në asnjë projektligj, ose gjatë ndonjë diskutimi me ndonjë nga grupet e interesuara. Të diskutuara gjerësisht brenda sektorit bankar, argumentohet se këto parashikime do të kenë një ndikim negativ në veprimtarinë bankare dhe jo vetëm.

Mbledhja e detyrimit financiar “me mirëkuptim të ndërsjellë” është një proces ligjërishit dhe proceduralisht i ndryshëm nga mbledhja e detyrimit financiar “përmes ekzekutimit të detyrueshëm”. Mbledhja e detyrimit financiar “me mirëkuptim të ndërsjellë” nënkupton procesin e negociatave, ndërmjet debitorit dhe kreditorit, ose një palë e tretë e autorizuar të veprojë në emër të kreditorit, për asnjë tarifë shtesë që do t'i ngarkohet debitorit. Nga ana tjetër, mbledhja e borxheve “përmes ekzekutimit të detyrueshëm” është një proces që fillon proceduralisht vetëm pas lëshimit nga gjykata të urdhrat ekzekutiv dhe sipas një procedure

ligjore specifike, të rregulluar me një ligj themelor, siç është Kodi i Procedurës Civile, shoqëruar me një tarifë që do t'i ngarkohet debitorit.

Ky ligj vendos një kufizim abuziv dhe monopolist në tregun e lirë me efekte të mundshme prishëse të tregut. Ligji përcakton gjithashtu një kufizim abuziv, duke përcaktuar veprimtarinë dytësore “për njoftimin e debitorëve dhe për mbledhjen e detyrimit financiar me mirëkuptim të ndërsjellë”, si një veprimtari që duhet të kryhet vetëm nga përbaruesit gjyqësor privat, duke monopolizuar një veprimtari, e cila nuk është thelbësisht unike dhe nuk kërkon aftësi specifike. Për më tepër, veprimtari të tilla përputhen me funksionimin e bankave dhe institucioneve financiare jo-banka, sipas ligjit: “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe me rolin e ndërmjetësit, siç përcaktohet me ligjin: “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, apo dhe sa parashikohet në Kodin Civil për ndërmjetësimin dhe ndërmjetësin. Ligji i ri parashikon që përbaruesi gjyqësor të veprojë në emër të kreditorit gjatë kryerjes së veprimtarisë dytësore (konflikt interesi), duke pasur parasysh se pas këtij procesi (nëse nuk rezulton i suksesshëm) kreditori, si hap të radhës, ka ekzekutimin e detyrueshëm nëpërmjet shërbimit përbarimor gjyqësor privat. Porë nga këndvështrimi i sektorit bankar, kjo dispozitë nuk ndihmon aspak për të zvogëluar detyrimet financiare të papaguara, përfshirë huat bankare; përkundrazi dëmton sistemin bankar

(dhe jo vetëm), pasi pengon/kufizon që bankat tregtare të kryejnë vet procesin e mbledhjes së borxhit financiar, me mirëkuptim të ndërsjellë. Por kjo nuk mbaron këtu. Kjo dispozitë kufizuese, që prish një treg dhe një proces që funksionon për shumë vite dhe ka dhënë rezultate të kënaqshme, synon t'i japë përmbaruesit funksionin e një institucioni financiar në mbledhjen e detyrimeve të papaguara (dhe gjithashtu negociimin e tyre), ndërsa funksioni i përmbaruesit në vetvete është i kufizuar në ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutiv, për ato detyrime që nuk janë përmbushur vullnetarisht, ose me mirëkuptim të ndërsjellë.

Ky akt dëmton drejtpërdrejt industrinë bankare, të gjitha institucionet e tjera të licencuara për huadhënie (e në përgjithësi të gjithë kreditorët) në procesin e mbledhjes së huave, apo detyrimeve financiare; u cakton përmbaruesve gjyqësorë privat statusin e institucioneve financiare, në procesin e mbledhjes së borxheve dhe negociatave të tyre. Veprimtaria e bankave tregtare dhe e institucioneve financiare jo-banka rregullohet dhe mbikëqyret nga Banka e Shqipërisë. Shoqëritë e licencuara për të vepruar në sektorin bankar kanë përfshirë në fushën e tyre të veprimtarisë procesin e kreditimit dhe financimit. Kreditimi dhe financimi përfshijnë edhe trajtimin e huave me probleme (transferimi, blerja dhe mbledhja me mirëkuptim) dhe kjo është e zbatueshme për të gjitha ato shoqëri të licencuara për të dhënë hua, ose thjesht për trajtimin e portofoleve me probleme. Ndaj ligji i ri për përmbaruesit privat ka ndërhyrë në lirinë e veprimtarisë ekonomike të shoqërive që kryejnë veprimtari për ndërmjetësimin dhe mbledhjen e huave me probleme; për më tepër, ai ka shkelur ligjin organik që rregullon veprimtaritë përkatëse. Përcaktimi me ligj që veprimtaria e mbledhjes së detyrimeve financiare me mirëkuptim

të kryhet vetëm nga përmbaruesit gjyqësorë privatë, privon bankat dhe institucionet financiare jo-banka që të ushtrojnë dhe ndjekin procedurat e aprovuara me ligj, për të cilat këto subjekte janë të licencuara nga Banka e Shqipërisë. Privimi i këtyre subjekteve nga kjo e drejtë shkel standardin kushtetues të së drejtës për lirinë e veprimtarisë ekonomike.

Nëmënyrë artificiale dhe pandonjë arsye të bazuar, ligji rrit detyrimet e debitorëve, që do të ngarkohen me shpenzime shtesë të paarsyeshme, të



Zbatimi i dispozitave të këtij ligji do të ndikonte negativisht në financimin dhe kreditimin e ekonomisë dhe mund të çojë në rritje artificiale të numrit të huave me probleme, pasi borxhi i papaguar nuk mblidhet/ekzekutohet në kohë, duke kërcënuar njëkohësisht stabilitetin financiar, pikërisht në momenti në të cilin – pas kaq shumë përpjekjeve – vërejmë një përmirësim të kënaqshëm në uljen e huave me probleme.



kërkuara nga përmbaruesi gjyqësor privat për veprimtarinë e tij. Ligji i ri ka parashikuar për këtë veprimtari dytësore një tarifë specifike, duke vendosur kështu një barrë të konsiderueshme për debitorët, duke përkeqësuar artificialisht pozicionin financiar të debitorit, tarifë kjo që nuk njihet/tarifohet kur mbledhja e detyrimit me mirëkuptim reciprok bëhet nga kreditori ose nën-kontraktorët e tij. Përcaktimi i kësaj tarife si kompetencë vetëm nga Ministri i Drejtësisë, shkel procesin legjislativ në përgjithësi,

pasi përcaktimi i tarifave është një kompetencë e përbashkët e Ministrisë së Financave, së bashku me Ministrinë e ministrisë përkatëse.

Ne besojmë fuqimisht se, dispozitat e kundërshtuara më sipër dëmtojnë interesin e përgjithshëm të të gjithë kreditorëve dhe debitorëve dhe krijojnë një konflikt të pastër interesi me funksionin parësor të përmbaruesit e, në terma të përgjithshëm, shkon kundër të drejtës kushtetuese të lirisë në krijimin e një veprimtarie ekonomike.

Në përmbledhje të sa më sipër, sa i përket industrisë bankare dhe financiare, zbatimi i dispozitave të këtij ligji do të ndikonte negativisht në financimin dhe kreditimin e ekonomisë dhe mund të çojë në rritje artificiale të numrit të huave me probleme, pasi borxhi i papaguar nuk mblidhet/ekzekutohet në kohë, duke kërcënuar njëkohësisht stabilitetin financiar, pikërisht në momenti në të cilin – pas kaq shumë përpjekjeve të përbashkëta nga Qeveria, rregullatorët, si dhe nga institucionet financiare ndërkombëtare dhe vendase – vërejmë një përmirësim të kënaqshëm në uljen e huave me probleme. Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB) ka mbështetur dhe do të vazhdojë të mbështesë përmirësimin e standardeve të kuadrit ligjor duke përfshirë këtu, sigurisht, edhe legjislacionin në lidhje me profesionet e lira brenda sistemit të drejtësisë, si dhe do të vazhdojë të kërkojë rregullimin e neneve përkatëse të ligjit nr. 26/2019 “Për shërbimin e përmbarimit gjyqësor privat”.

KËTU PËR JU!



**Mbështetje e pakushtëzuar,
në çdo kohë!**



TIRANA BANK

KËTU PËR JU

Informaliteti i lartë i ekonomisë dhe përdorimi i ulët i kartave dhe terminaleve bankare

Niveli i informalitetit, sidomos në qytetet bregdetare, mbetet veçanërisht problematik, ndaj dhe bizneset operojnë në informalitet, e për këtë arsye, ndoshta nuk parapëlqejnë të instalojnë POS-e, për të fshehur xhiron, por edhe si pjesë e konkurrencës së pandershme.



Diana LEKA

Drejtoresh
SEKRETARIATI I KËSHILLIT SHQIPTAR
TË INVESTIMEVE

Informaliteti ka qenë një nga shtyllat kryesore të punës sonë që në fillim, në kuadër të stimulimit të debatit mbi problematikat kryesore të klimës së investimeve në vend. Sekretariati i Këshillit të Investimeve ka analizuar informalitetin (2015-2019) në ekonominë shqiptare në përgjithësi, si dhe në sektorë të veçantë, si: turizmi dhe bujqësia. Konkretisht, në turizëm analiza synoi të evidentojë në çfarë mase veprimtaria ekonomike¹ ndikohet nga veprimtaria informale dhe evazoni fiskal, ku me “ekonomi informale” nënkuptohen veprimtari të ekonomike që përfshijnë transaksionet monetare, që lidhen me veprimtari ekonomike të ligjshme, që mbartin evazion fiskal, ose shmangie taksash. Theksojmë se, pjesa kryesore e subjekteve në turizëm (rreth 300), që u përfshinë në analizë ishin biznes i vogël dhe


i mesëm, kryesisht “akomodim hotelieri” dhe “agjenci turistike”. Gjatë analizës dhe konsultimeve u evidentua si problematikë numri i ulët i transaksioneve me karta debiti/krediti në përgjithësi në vend, por specifikisht, në zonat turistike. Problematika u perceptua fillimisht si problem nga këndvështrimi i turistëve, sesa i pronarëve të strukturave akomoduese/restoranteve/bareve, etj. Kështu, turistët kishin evidentuar raste të mungesës së POS-eve në zonat turistike, duke bërë shpesh pagesa me para në dorë. Ndërkohë, kishte raste që pronarët e subjekteve ishin të pajisur me POS-e, por ata vinin në dukje koston e mirëmbajtjes së tyre, për sa kohë që numri i përdoruesve nuk ishte i lartë.

Gjithashtu, Sekretariati ju referua edhe disa studimeve që konfirmonin një lidhje të drejtpërdrejt midis nivelit të informalitetit dhe nivelit të ulët të transaksioneve, nëpërmjet mjeteve elektronike, si: POS-et², ose pagesat nëpërmjet telefonave celularë, sidomos në sektorët e tregtisë

dhe shërbimeve. Kjo, për faktin se pagesat me para në dorë, nuk lënë asnjë gjurmë dhe mundësojnë shmangien e raportimit të tyre, si pjesë e xhiros, duke u bërë një nga shkaqet e ekonomisë së fshehur dhe shmangieve tatimore në turizëm. Nga ana tjetër, edhe numri dhe përdorimi i kartave të debitit dhe kreditit nga popullata mbetet ende më i ulët në rajon. Po kështu, u analizuan edhe të dhënat zyrtare nga Banka e Shqipërisë³, ku rezultoi se, numri i përgjithshëm i terminaleve POS në Shqipëri, deri në fund vitin 2018, ishte vetëm 8.726, nga të cilat 7.259 ndodheshin në qarkun e Tiranës. Në tremujorin e tretë të 2019-ës, numri i përgjithshëm i terminaleve POS u rrit në 10.837, por mbetet ende më i ulët në rajon.

Në këtë kontekst, rekomanduar një analizë më të thelluar të problemit, edhe në kuadër të globalizimit dhe krahasimit me vendet e rajonit, por edhe në perspektivën e rolit të rëndësishëm që ka edukimi i gjithëpërfshirjes financiare në ekonomi.

Përqindja e shoqërive që perceptojnë konkurrencë nga veprimtari të ekonomike informale, sipas rajoneve dhe përmasave të biznesit.



Burimi: Llogaritjet tona, bazuar në të dhënat e anketës së KI 2018

¹ Kuptimi dhe matja e informalitetit në turizëm mbetet një sfidë e madhe për faktin që sektori bazohet në “shared economy” dhe ka ndërveprim me zinxhirë të tjerë të vlerës së ekonomisë.

² Reduktimi i ekonomisë së fshehtë përmes pagesave elektronike - Ernst & Young / MasterCard (2016)

³ https://www.bankofalbania.org/Pagesat/Statistika_te_sistemeve_te_pagesave/

1. Arsyet e përdorimit ende të ulët të këtyre instrumenteve në Shqipëri.

Niveli i ulët i përdorimit të këtyre instrumenteve nga biznesi, sidomos ai i vogël dhe i mesëm, lidhet me kostot, procedurat dhe qasjen e kufizuar në shërbimet bankare. Niveli i informalitetit, sidomos në qytetet bregdetare, mbetet veçanërisht problematik, ndaj dhe bizneset operojnë në informalitet, e për këtë arsye, ndoshta nuk parapëlqejnë të instalojnë POS-e, për të fshehur xhiron, por edhe si pjesë e konkurrencës së pandershme. Kjo gjendje po ndryshon disi, meqenëse sektori është në rritje dhe një shërbim i tillë është kërkesë e kohës, veçanërisht në turizëm, ku turistët e huaj kërkojnë standard. Nga pikëpamja sektoriale, ndonëse strategjik për vendin, turizmi apo bujqësia, mbeten sezonale, e për rrjedhojë, subjektet (veçanërisht të vogla e të mesme) konsiderojnë kostot e mundshme të këtij shërbimi bankar. Ndërkohë, Shqipëria mbetet një destinacion i ri turistik, me sfidën për t'u pozicionuar në tregun botëror. Ndaj, dinamikat e fundit të analizuara nga KI, por jo vetëm, evidentojnë potenciale të rritjes së kërkesës, por duhet të analizohen me "kërkesën për cilësi" dhe konkurrueshmëri, edhe nga ana e kërkesës. Kuptimi i veçorive të sektorit nga ana e ofertës, përfshirë edhe atë të pagesave me kartë, mbeten mjaft të rëndësishme, duke qenë se shumë nga sfidat që ka sektori sot lidhen me strukturën dhe cilësinë e ofertës, pavarësisht zhvillimeve të rëndësishme në sektor.

2. Disa nga masat që duhen marrë, për të nxitur përdorimin e këtyre instrumenteve

Sigurisht, sistemi i pagesave është pjesë e rëndësishme e infrastrukturës financiare të vendit dhe lidhet me një sërë faktorësh,

përfshirë institucionet, rregullat, apo dhe standardet që mundësojnë ndërveprimet nga ana financiare, ku mbështetja ndaj NMV-ve në sektorët prioritarë kërkon fokus të veçantë. Në këtë kontekst, në kuadër dhe të formalizimit të ekonomisë, ndërhyrja nuk duhet të jete me politika të pjesshme, por e integruar me bashkëpunim të aktorëve kryesorë: qeveri, bankë qendrore, sektor bankar, por dhe vet subjektet private, që janë të interesuara për konkurrencën e ndershme, pasi "informaliteti i lartë sjell informalitet". Përveç përdorimit të kartave bankare, si mjet



Bizneset hezitojnë bashkëpunimin në tërësi me bankën, duke mos vënë sinjalistikën e duhur në mjediset e biznesit, duke fshehur POS-et, si dhe duke pranuar pagesë me karta në mënyrë selektive.



pagese, theksi duhet të vendoset në përgjithësi te qasja e ulët/kufizuar në shërbime financiare të bizneseve dhe individëve, për shkak të pranisë së kufizuar të bankave, numrit të ulët të POS-eve, kostove të larta administrative dhe atyre të mirëmbajtjes, lidhur me llogaritë bankare dhe mungesën e marrjes përsipër nga BANKAT të ndonjë rreziku, që lidhet me financimin në përgjithësi dhe nxitjen e përdorimit të instrumenteve të pagesës, në veçanti.

Nga ana tjetër, duhet rritur aksesin i popullatës dhe biznesit në shërbimet bankare, nëpërmjet edukimit financiar dhe rritjes së besimit te sektori bankar, e njëkohësisht duhet rritur transparenca e bankave mbi

kostot e shërbimeve dhe të kartave, e në veçanti të mund të rivlerësohen komisionet bankare mbi pajisjen dhe mirëmbajtja e këtyre instrumenteve. Gjithashtu, nevojitet bashkërendim i masave anti-informalitet dhe ato që nxisin formalizimin vullnetar midis Ministrisë së Financave & Ekonomisë dhe Bankës së Shqipërisë, si p.sh.: inkurajimi i përdorimit të kartave nëpërmjet instrumenteve fiskale dhe në të njëjtën kohë, afrimi i shërbimeve bankare me pranë bizneseve, veçanërisht atyre të vogla.

Së fundi, Këshilli i Investimeve do të rekomandonte që: Inkurajimi i pagesave përmes përdorimit të POS-eve dhe pagesave elektronike do të ndikonin në nivelin e lartë të ekonomisë së fshehtë në veprimtarinë e turizmit, ato do të rrisnin pajtueshmërinë e biznesit me tatimet dhe do të kontribuonin ndjeshëm në rritjen e transparencës dhe reputacionit të ofertës shqiptare në turizëm, sidomos për të huajt. Mënyrat e përballimit të kësaj sfide duhet të jenë objekt diskutimi të mëtejshëm me Bankën e Shqipërisë, bankat tregtare dhe Ministrinë së Financave & Ekonomisë, me qëllim gjetjen e një zgjidhjeje të pranueshme dhe shmangien e kostove shtesë për bizneset, sidomos për mikro-bizneset. Praktika ndërkombëtare ofron disa masa që mund të ndiqen. Përveç sa më sipër, zbatimi në praktikë i rregullave mbi kategorizimin dhe klasifikimin e strukturave akomoduese, sipas dispozitave të dekretit Nr.730 datë 20.10.2016 të Këshillit të Ministrave: "Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifatat, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave të akomodimit", të cilat e bëjnë të detyrueshëm përdorimin e terminaleve POS në hotele/resorte me 4 dhe 5 yje, do të ndihmonin në formalizim.

Hezitimi i bashkëpunimit me bankën dhe informaliteti

Pengesa serioze në rritjen e përdorimit të kartave dhe POS-eve

Vihet re hezitim dhe pasiguri nga ana e bizneseve, që në hapat e parë, për të bërë regjistrimin në bankë dhe çeljes se llogarisë së biznesit, e më tej ky hezitim vihet re pas pajisjes me terminal POS, ku terminali mbahet i fukur, fshihet dhe klientëve nuk i ofrohet mundësia e pagesës me kartë.



Erion MAXHARI

Kryetar i Komitetit të Kartave
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE, AAB

Sikurse është vendosur në pah edhe nga Këshilli i Investimeve, në sektorin e turizmit ekzistojnë problematika me peshë, të cilat kanë shkaqe kryesisht edhe nga vet bizneset. Lidhur me zgjerimin e rrjetit të pikave POS, nuk mendoj që problemi kryesor është sezonaliteti, ose elementë të tjerë të lidhur me biznesin e infrastrukturën, por mendoj që një domosdoshmëri është eliminimi dhe luftimi i frymës

së informalitetit të krijuar pikërisht në këto zona.

Nga prespektiva infrastrukturore, ne si Komitet i Kartave nuk besojmë se ka ndonjë pengesë, pavarësisht kostove që zgjerimi i këtyre terminaleve kërkon, si: kosto investimi në pajisje, kosto ndërldhje, mirëmbajtje por edhe trajnimi. Bankat në Shqipëri u kanë ofruar bizneseve kryesisht shërbimin e pranimit të kartave në POS pa komisione fikse mirëmbajtje, por vetëm me tarifim për transaksion, ky i fundit i domosdoshëm për shkak edhe të kostove të ndërveprimit me rrjetet e kartave VISA, MasterCard, AmericanExpress, etj. Bankat shqiptare kanë ofruar edhe shërbime ekstra: sikurse POS në monedhën Euro, një përparësi, si për klientin ashtu edhe për biznesin, duke mos pasur humbje nga konvertimi, por edhe një zgjerim të terminaleve ATM në këto zona.

Ndërkohë, Komiteti i Kartave vë re se, pavarësisht zbutjes së kostove nga ana e bankave, shikohet në tërësi hezitim nga një masë e gjerë e bizneseve për t'u pajisur

me shërbimin e terminaleve POS. Kjo, për shkak të problematikave të specifikuar edhe nga studimi i kryer i Këshilli i Investimeve, si: largësia nga degët/rrjeti i bankave, sezonaliteti, probleme në infrastrukturë, edukim, por jo vetëm. Sipas këndvështrimit tonë vihet re hezitim dhe pasiguri nga ana e bizneseve, që në hapat e parë, për të bërë regjistrimin në bankë dhe çeljes se llogarisë së biznesit, e më tej ky hezitim vihet re pas pajisjes me terminal POS, ku terminali mbahet i fukur, fshihet dhe klientëve nuk i ofrohet mundësia e pagesës me kartë. Për më tepër, është i rëndësishëm fakti që, kryesisht bizneset hezitojnë bashkëpunimin në tërësi me bankën, duke mos vënë sinjalistikën e duhur në mjediset e biznesit, duke fshehur POS-et, si dhe duke pranuar pagesë me karta në mënyrë selektive. Pavarësisht se një pjesë e bizneseve bëjnë këto veprime për shkak të mostrajnitimit të duhur të tyre, ose të punonjësve, shkak kryesor mbetet informaliteti i lartë, në shumicën e rasteve, sidomos në zonat turistike dhe bizneseve të vegjël.



Siguria kibernetike në një botë të ndërlidhur

Siguria kibernetike padyshim që do të vazhdojë të jetë shqetësim në ardhmen e parashikueshme, por kërcënimi mund të shndërrohet në një problematikë të menaxhueshme, nëse organizatat financiare janë vigjilente, sigurojnë një mbrojtje të fuqishme në rrjet dhe bashkëpunojnë me njëri-tjetrin, sa më shumë që të jetë e mundur.



Gizem TANSU, ICA

Nisma për Përputhshmëri të Luftës kundër Krimin Financiar
EMEA, SWIFT

Kur diskutohet për përdorimin e Teknologjisë së Informacionit (TI), sektori financiar është pa dyshim ndër më të përparuarit dhe që ka investuar shumë në sistemet e sigurisë së TI-së. Ai përbën gjithashtu një nga universet më të ndërlidhura mes vetes – e sigurisht edhe një objektiv tërheqës për keqbërësit e rrjetit. Forumi Ekonomik Botëror (WEF) i ka cilësuar sulmet në rrjet (internet), për disa vite me radhë, si rreziku më i madh në rrafsh global. Siguria kibernetike për institucionet financiare në Shqipëri është përballë një rreziku të qartë dhe të prekshëm, ashtu siç është edhe për sipërmarrjet në gjithë botën. Mashtrimi dhe kërcënimet në rrjet janë pa dyshim sfidat e reja për industrinë financiare.

Sidoqoftë, vitet e fundit është vënë re se kërcënimet janë bërë

gjithnjë e më të organizuara, më të sofistikuara dhe më globale, se kurrë më parë. Në fillim të vitit 2016, rasti i Bankës së Bangladeshit u bë i njohur si viktimë e një sulmi në rrjet, që rezultoi në një vjedhje në tentativë. Ndërsa, që u grabitën vetëm një pjesë e fondeve, ngjarja dëshmoi një moment domethënës për industrinë financiare. Kështu, u bë shpejt e qartë se ky incident nuk do të ishte një ngjarje e vetme, përkundrazi, ai do të ishte pjesë e një fushate më të gjerë dhe tejet e zbatueshme në praktikë, duke synuar tashmë



Bankat në Shqipëri nuk funksionojnë në boshllëk dhe janë pjesë e një ekosistemi më të gjerë financiar. Ato bashkëveprojnë dhe kryejnë transaksione me shumë homologë, në baza ditore, kështu që rreziqet ndaj sigurisë në internet që shfaqen nga këta homologë duhet gjithashtu të vlerësohen.



bankat në të gjithë botën. Brenda pak viteve, që nga ngjarja e Bankës së Bangladeshit, kemi qenë dëshmitarë të faktit që kërcënimi kibernetik vazhdon të marrë përmasa, ku tashmë bankat përballen me sulme të niveleve të shtuara të sofistikimit.

Në këtë industri, kriminelët e rrjetit kërkojnë të korruptojnë

mjedisin operacional lokal, si dhe proceset e pagesave të institucioneve financiare, duke grabitur kredencialet e vlefshme të operatorit dhe duke iniciuar transaksione mashtruese, drejtpërdrejt në ndërfaqen që lidhet me rrjetin SWIFT. Kriminelët e rrjetit janë të aftë dhe të vendosur, mund të thyejnë rrjetet brenda disa minutash, e më pas, të fshehin gjurmët për muaj të tërë. Sapo dërgohen pagesat mashtruese, sulmuesit zakonisht i mbulojnë gjurmët, duke fshehur provat e veprimeve të tyre. Nëpërmjet përdorimit të mjeteve dhe teknikave të ndryshme, ato fshijnë ose manipulojnë të dhënat dhe i korruptojnë me vetëdije sistemet, me qëllim që të ngatërrojnë ekspertët kriminalistë. Sa më shumë kohë i duhet një banke për të pikasur se është sulmuar, as më shumë mundësi kanë kriminelët që të tërheqin plotësisht fondet jashtë sistemit (rrjetit).

Që nga incidenti i Bankës së Bangladeshit, bankat i kanë kushtuar burime të konsiderueshme forcimit të mbrojtjes së tyre. Por ndërsa industria po rrit mbrojtjen e saj, kriminelët e rrjetit po ndryshojnë taktikat e tyre. Fillimisht, ata do të inicionin pagesa mashtruese, jashtë orarit zyrtar të punës, për të shmangur zbulimin, por kohët e fundit e kanë ndryshuar qasjen krejtësisht, duke vepruar gjatë orarit zyrtar të punës, për t'u bashkuar me trafikun normal të pagesave. Gjithnjë e më shumë, keqbërësit po përdorin korridore të reja pagese dhe kanë filluar të përdorin

monedhat evropiane, në përpjekjet e tyre mashtruese, përveç dollarit amerikan.

Këto taktika të reja e bëjnë më të vështirë për bankat që të zbulojnë transaksionet e pazakonta. Megjithatë, ka instrumente që mund të përdoren nga bankat shqiptare, për t'i ndihmuar ato të kontrollojnë që transaksionet e tyre janë me të vërtetë të ligjshme. Instrumentet kundër mashtrimeve i ndihmojnë ato në zbulimin e tyre, duke analizuar të dhënat dhe duke kërkuar prirjet dhe anomalitë, që mund të ndihmojnë në parandalimin e sulmeve të mundshme. Instrumente të tilla janë të rëndësishme për të ndihmuar në forcimin e mbrojtjes së komunitetit financiar global, ndaj kërcënimeve në internet, pasi frekuenca dhe shpejtësia e pagesave rritet, ndërkohë që përdorimi i tyre ka një ndikim pozitiv të prekshëm, për të ndihmuar bankat të mbrojnë veten nga mashtrimet. Për shembull, Shërbimi i ri i Kontrollit të Pagesave të SWIFT-it siguron monitorimin në kohë reale, "që në ajër" të pagesave që dërgojnë përdoruesit e SWIFT-it. I ofruar brenda rrjetit të SWIFT-it dhe që nuk lë gjurmë, ky filtër transaksionesh i vijës së fundit të mbrojtjes është i pavarur nga sistemet e brendshme të cilto përdoruesi, ose nga sistemet anti-mashtrim, të cilat mund të jenë

komprometuar gjatë një incidenti në rrjet.

Bankat në Shqipëri nuk funksionojnë në boshllëk dhe janë pjesë e një ekosistemi më të gjerë financiar. Ato bashkëveprojnë dhe kryejnë transaksione me shumë homologë, në baza ditore, kështu që rreziqet ndaj sigurisë në internet që shfaqen nga këta homologë duhet gjithashtu të vlerësohen. Praktikrat e bankave "Njih-klientin-Tënd" (KYC) mund të ndihmojnë në këtë drejtim, duke i lejuar bankat të centralizojnë dhe shpërndajnë informacione rreth vetes të palët e treta. Nisur nga besueshmëria e lartë që bankat kanë ndaj njëra-tjetrës përmes marrëdhënieve tregtare të vendosura me klientët, qasja ndaj praktikave KYC përbën një logjikë të fortë biznesi. Regjistri KYC i SWIFT-it, për shembull, përmban më shumë se 5,000 institucione financiare dhe u mundëson bankave të japin informacion të verifikuar, duke e bërë më të lirë dhe më të lehtë për korrespondentët e tyre të përdorin informacionin e nevojshëm.

Një fushë tjetër me rëndësi kritike në trajtimin e krimit në internet është shkëmbimi i informacionit, veçanërisht duke pasur parasysh natyrën globale dhe të ndërlidhur të industrisë financiare. Sa më i përshtatshëm dhe në kohë të jetë informacioni inteligjent që mund të

shpërndajë komuniteti financiar - përmes kanaleve të besuara - aq më shumë mundësi ka që të shmanget ose minimizohet një sulm. SWIFT ka lançuar Qendrën e Ndarjes dhe Analizës së Informacionit (SWIFT ISAC), për të lehtësuar qasjen e komunitetit (financiar) në inteligjencën aktive ndaj rrezikut për sigurinë kibernetike, duke i dhënë mundësi atij të mbrohet më mirë ndaj sulmeve të mundshme në internet. Gjithashtu, SWIFT është angazhuar me ekspertë të industrisë, siç janë shitësit e anti-viruseve dhe ekipet e reagimit ndaj incidenteve. Tashmë po shihen dhe frytet e këtij bashkëpunimi, që kanë rezultuar në identifikimin e shpejtë të institucioneve financiare të vëna në shënjestër nga keqbërësit në rrjet, - në shumicën e rasteve përpara se sulmuesit të ishin në gjendje të gjeneronin mesazhe mashtruese.

Lufta ndaj mashtrimeve përbën një sfidë për të gjithë industrinë financiare dhe nuk ka zgjidhje të shpejta. Siguria kibernetike padyshim që do të vazhdojë të jetë shqetësim në ardhmen e parashikueshme, por kërcënimet mund të shndërrohet në një problematikë të menaxhueshme, nëse organizatat financiare janë vigjilente, sigurojnë një mbrojtje të fuqishme në rrjet dhe bashkëpunojnë me njëri-tjetrin, sa më shumë që të jetë e mundur.



Kartat Union Bank

Bli me kartë
dhe dhuro!



 **UNIONBANK**
Banka që dua

Për çdo blerje me kartën tuaj Union Bank,
një fëmijë në **Fshatin SOS** merr një dhuratë.

Përgjegjësia Sociale - një urë drejt Zhvillimit të Qëndrueshëm

Sot, shoqëritë tregtare duhet të ushtrojnë veprimtarinë e tyre duke zbatuar projekte të përgjegjësive sociale, të cilat sigurojnë qëndrueshmëri për shoqërinë, mjedisin dhe mirëqeverisjen.



Ardita SEKNAJ

Sekretare e Përgjithshme
DHOMA NDËRKOMBËTARE E TREGTISË, ICC

Qëllimi tradicional i një shoqërie tregtare përkufizohet me të bërit fitim dhe shpërndarjes së këtij fitimi te aksionarët. Mirëpo, qëllimet e shoqërive tregtare sot janë më të fokusuara drejt gjetjes dhe zhvillimit të zgjidhjeve të qëndrueshme, të cilat sigurojnë fitime afatgjata për aksionarët.

Sa më shumë rritet një shoqëri tregtare, aq më i madh është ndikimi dhe vlera që sjell në ekonomi dhe shoqëri. Nga ana tjetër, sfidat me të cilat përballlet sot një shoqëri tregtare janë shumë më komplekse dhe dinamike se disa vite apo dekada më parë. Për t'iu përgjigjur më mirë këtyre sfidave, shoqëritë tregtare ndërtojnë planet e tyre të biznesit, tashmë jo vetëm duke u bazuar në fitimin, por edhe në vlerën dhe investimin që mund të

bëjnë në përmirësimin e shoqërisë, mjedisit apo mirëqeverisjes. Përgjegjshmëria sociale është një ndër ato procese, që është bërë tashmë pjesë integrale e të bërit biznes. Përgjegjshmëria sociale përbën për shumë shoqëri tregtare pjesë të vlerave të aksionarëve dhe menaxherëve të lartë. Përgjegjshmërinë sociale si koncept e gjejmë të zbatuar në forma të ndryshme në vende të ndryshme sipas zhvillimit të ekonomisë apo të vetë tregut.

Përgjegjshmëria sociale, në kuptimin më primitiv, ndërtohet në kuadër të një nevojë aktuale të aksionarëve të saj për të kompensuar shoqërinë për përdorimin e burimeve që po i bën përmes veprimtarisë së saj, sikurse janë sponsorizimet. Në rastin më të avancuar, përgjegjshmëria sociale zhvillohet si pjesë integrale e proceseve, shërbimeve, produkteve dhe e kulturës së shoqërisë tregtare, duke u përpjekur për të krijuar një balancë mes burimeve të përdorura dhe ofertës që i jepet shoqërisë përgjatë një periudhe kohore. Sot nuk mjafton që një shoqëri tregtare të ushtrojë veprimtari dhe të promovojë veten me veprimtari të përgjegjshmërisë sociale. Sot, shoqëritë tregtare duhet të ushtrojnë veprimtarinë e tyre duke zbatuar projekte të përgjegjësive sociale, të cilat sigurojnë qëndrueshmëri për shoqërinë, mjedisin dhe mirëqeverisjen.

Zhvillimi i qëndrueshëm

varet nga zgjidhjet, mundësitë, kontributet dhe angazhimet e bizneseve.

Për këtë arsye, institucione ndërkombëtare zhvillojnë instrumente dhe mjete, të cilat u mundësojnë palëve të interesit zgjidhje për të përshtatur veprimtarinë e tyre me zhvillimet e tregut dhe ekonominë, jo vetëm në nivel lokal, por edhe në atë rajonal e global. Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë, një organizatë biznesi me mbi 45 milionë anëtarë në të gjithë botën, ka prodhuar prej vitesh instrumente dhe mjete, të cilat i vijjnë në ndihmë bizneseve dhe palëve të tjera të interesit për të orientuar veprimtaritë e tyre në drejtim të zhvillimit të qëndrueshëm dhe zbatimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Statuti i Biznesit për Zhvillimin e Qëndrueshëm ofron për bizneset, por edhe për palë të tjera, tetë rekomandime parimore, të cilat synojnë ushtrimin e një aktiviteti të qëndrueshëm.

Tetë parime për Zhvillimin e Qëndrueshëm

Bëjeni zhvillimin e qëndrueshëm një prioritet biznesi

Është thelbësore që të gjithë aktorët në ekonomi, përfshirë qeveritë, organet ndërqeveritare, biznesi, shoqëria civile dhe konsumatorët të konsiderojnë zhvillimin e qëndrueshëm si një përgjegjësi të përbashkët dhe të ndërmarrin veprime në nivel lokal, kombëtar, apo global, për sfidat dhe përfitimet që e shoqërojnë atë.

Objektivi 5,8,12,16: Rritje Ekonomike dhe Zhvillim i Qëndrueshëm

Duhen zhvilluar dhe promovuar modele gjithëpërfshirëse biznesi, të cilat plotësojnë nevojat e një ekonomie më të qëndrueshme. Me qëllim që një ekonomi e qëndrueshme të bëhet operative, është tepër kritike që të zhvillohen tregues, standarde, mjetet kontabël dhe deklarimet përkatëse për këtë synim. Nevojitet një qasje më e mirë në raportimin e qëndrueshmërisë, për të siguruar që të gjithë aktorët përkatës kanë fleksibilitetin e nevojshëm për të pasqyruar rrethanat e tyre të veçanta dhe mbështetjen e duhur për t'u angazhuar në raportimin e qëndrueshmërisë në mënyrën e duhur.

Objektivi 1,2,3,4,5,8,11,12: Përgjegjësia mjedisore dhe menaxhimi

Kalimi në një rritje më të qëndrueshme kërkon që gjurma mjedisoreve primarive ekonomike të minimizohet dhe që përdorimi efikas i burimeve natyrore të përmirësohet në vijimësi. Në këtë kontekst, biznesi duhet të ndërmarrë hapa për të njohur dhe vlerësuar ndikimet mjedisore që lidhen me veprimtaritë e biznesit dhe të maksimizojë efikasitetin e të gjitha burimeve natyrore, veçanërisht atë të ujit, energjisë dhe tokës.

Objektivi 6,7,8,9,11,12,13,14,15: Përgjegjshmëria për njerëzit dhe shoqërinë

Biznesi mund të mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm, duke siguruar punë dhe kushte jetese të mirë, duke krijuar vlera, duke kontribuar në zhdukjen dhe zbutjen e varfërisë dhe duke nxitur prosperitetin. Qasja në edukim është një faktor mjaft i

rëndësishëm për zhvillimin dhe rritjen ekonomike e si rrjedhojë, edhe për zhvillimin e qëndrueshëm. Angazhimi i bizneseve në forcimin e kapaciteteve punëtore, por edhe në shtimin e përpjekjeve për qasje në edukim për të gjithë është thelbësor për zhvillimin e qëndrueshëm. Gjithashtu, bizneset e përgjegjshme, përveçse zbatojnë parashikimet ligjore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të drejtave të punëtorëve apo të mjedisit, duhet të synojnë që edhe t'ia bëjnë të ditur dhe t'i kërkojnë përmbushje të këtyre detyrimeve edhe partnerëve të tyre të biznesit.

Objektivi 1,2,3,4,5,8,9: Produktet dhe shërbimet

Kalimi drejt një ekonomie më të qëndrueshme kërkon përpjekje afatgjata nga të gjithë aktorët e përfshirë si dhe adoptimin e kësaj qasje gjatë "ciklit jetësor" të produktit dhe në të gjithë sektorët. Bizneset nevojitet të zhvillojnë produkte që ofrojnë vlerë të mirë për klientin, janë të sigurta në përdorim, janë në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi dhe minimizojnë ndikimet negative në mjedis dhe /ose shoqëri.

Objektivi 3,6,8,11,12,13: Qasje drejt zinxhirit të vlerave

Bizneset i përkushtojnë përpjekje të shtuara menaxhimit të rreziqeve të lidhura me zinxhirin e vlerës dhe ndërtimit të marrëdhënieve afatgjata me furnitorët, klientët, agjentët, distributorët dhe partnerët e tjerë.

Objektivi 5,8: Transparencë, komunikim dhe raportim

Vendimmarrja e biznesit duhet të bazohet jo vetëm në vlerësimin e qëndrueshmërisë, por edhe në transparencë dhe raportim të proceseve dhe praktikave për

shpërndarjen e fondeve, apo përzgjedhjes sipas kriterëve. Bizneset duhet të zhvillojnë raportimin e qëndrueshmërisë. Raportimi i qëndrueshmërisë mund të jetë një mjet i fuqishëm komunikimi, i cili mund të ndihmojë shoqëritë tregtare të përgjigjen për nevojat e aksionarëve, investitorëve si dhe për të matur ndjekjen dhe përmirësimin e ecurisë së qëndrueshmërisë së biznesit.

Objektivi 5,8,12,16: Bashkëpunim dhe partneritet për përmirësim të vazhdueshëm

Bizneset duhet të nxisin bashkëpunimet novatore për krijimin e vlerës së përbashkët, siç janë: angazhimet dhe aleanca me bizneset e tjera, institucionet akademike, qeveritë ose konsumatorët, për të ofruar punë, modele dhe zgjidhje novatore. Bizneset duhet të angazhohen me punonjësit, aksionarët dhe palët e tjera të interesit, përmes dialogut dhe komunikimit të vazhdueshëm. Duke vepruar kështu, biznesi mund të krijojë një besim në publikun e gjerë.

Objektivi 17

Këto tetë parime synojnë të kontribuojnë në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm nga ana e bizneseve. Mirëpo, arritja e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm nuk mund të realizohet nga vetëm një palë dhe, prandaj, bizneset duhet të përfshihen në partneritet të zgjeruar publiko-privat në nivel kombëtar dhe më gjerë ku mund të ndahen eksperiencia dhe ekspertiza nga të gjitha palët.

Parimet e mësipërme janë pjesë e Statutit të Biznesit për Zhvillimin e Qëndrueshëm të publikuar nga ICC dhe të punuar në bashkëpunim me ekspertët e bizneseve anëtare në rrafsh global.

Shkaqet dhe pasojat e luftërave tregtare – fituesit dhe humbësit

Lufta e monedhave Kinë-SHBA dhe zhvlerësimet reciproke të monedhave të tyre, USD dhe yuan-i, mund të provokonte rritjen e vlerës së Euros, uljen e konkurrueshmërisë së eksporteve të saj industriale, rrezikun e një lufte të hapur në import – eksportet e sektorit të automobilave dhe produkteve agro-ushqimore, duke shtuar rrezikun e shfaqjes së prirjeve recesioniste.



Prof. Dr. Adrian CIVICI

Dekan, Fakulteti i Shkencave Ekonomike
UNIVERSITETI MESDHETAR I SHQIPËRISË

Në mars të vitit 2018, dhjetë vite pas shpërthimit të krizës financiare globale, z. Donald Trump, President i SHBA-ve, deklaronte se: “luftërat tregtare janë të mira dhe të lehta për t’u fituar”. Bëhej fjalë për fillimin e një konflikti të madh tregtar SHBA – Kinë, që gradualisht do përfshinte në vorbullën e tij shtete dhe kontinente të tërë, me efekte e pasoja nga më të paparashikueshmet. “Kur dy elefantë grinden në savanë, ka gjasa që ata edhe të plagosen, por një gjë është e sigurt: bari në fushën e betejës do të zhduket”. Në ekonominë botërore të globalizuar, lufta tregtare ndërmjet dy fuqitë më të mëdha të botës rrezikon të shkaktojë rreziqe të mëdha për vendet e tjera, të zhvilluara apo në zhvillim qofshin ato. E gjithë rritja ekonomike botërore ndihet e kërcënuar nga lufta

tregtare SHBA-Kinë. Për tregtinë botërore, një situatë e tillë nuk ishte parë që nga vitet 1930-të, në kuadër të efekteve të “Depresionit të madh”.

Për Presidentin Trump, “inati” me Kinën kishte filluar që në vitin 2016, gjatë fushatës elektorale, kur Kina akuzohej se “po dhunonte SHBA-të”, se ajo ishte “hajdutja më e madhe në historinë botërore”. Fuqia më e madhe eksportuese e planetit që në vitin 2009 dhe pastaj vendi i parë në ekonominë botërore në vitin 2014 duhej të përballej me sloganin e famshëm “Make America Great



Lufta tregtare u shtri edhe në politikat monetare dhe kurset e këmbimit. Në përgjigje të “sulmit amerikan” mbi eksportet kineze, Pekini zhvlerësoi monedhën e tij yuan-in në një nivel më të ulët në raport me dollarin se viti 2008, me gjithë rreziqet dhe humbjet që një veprim i tillë paraqiste për tërheqjen e investimeve të huaja dhe flukseve të kapitalit në ekonominë kineze.

Again”. Rreth 558 miliardë dollarë eksporte kineze drejt SHBA-ve në 2018, ndërkohë që në krahun e kundërt ishin vetëm 178 miliardë dollarë eksporte, me një deficit tregtar prej 380 miliardë dollarë. Administrata

e SHBA-ve mendonte se Kina “po shkelte rregullat”, duke i vënë vetes për mision “rivendosjen e ekuilibrit tregtar” ndërmjet dy superfuqive më të mëdha të planetit, “duke i dhënë një leksion Pekinit”.

Po ku qëndronte “ekzagjerimi” kinez? Në kuadrin e OBT-së, por edhe në marrëdhëniet bilaterale me SHBA-të, apo BE-në, Kina është akuzuar shpesh se “ka një koncept mjaft specifik e personal për ekonominë e tregut”, për “praktikat e subvencionimit masiv të bizneseve e korporatave, duke i garantuar atyre pjesë të rëndësishme të tregjeve publike”, “për praktika evidente dumpingu”, “për detyrimin që iu vendos sipërmarrjeve të huaja që investojnë në Kinë që t’ia dhurojnë Kinës teknologjitë e tyre”, “për politika jo transparente me markat dhe patentat, sidomos në sferën e teknologjisë high-tech”, “për blerje me fonde shtetërore të korporatave të huaja, në mënyrë që të dominojë dhe kontrollojë tregun”, etj. Reagimi i SHBA-ve është përballja e drejtpërdrejtë “me dorë të hekurt” kundër Pekinit, me logjikën se “do t’i taksojmë gjithnjë e më shumë deri sa të sillen në mënyrë korrekte”.

“Lufta” filloi me rritjen 25% të taksës mbi importet e çelikut dhe 10% të importeve mbi aluminin. Z. Trump deklaroi se “mbi 1,300 produkte kineze do taksohen”. Pekini u përgjigj menjëherë me një listë prej 128 produktesh amerikane që do taksoheshin nga 15-25%. Kështu filloi. Taksa, kundërtaksa, taksa, kundërtaksa...! Deri në gusht 2019, vlera e taksimit të produkteve kineze



të eksportuara në SHBA e kaloi shifrën e 300 miliardë dollarë; Kina ju përgjigj këtij "ping-pongu" me një shifër taksash për eksportet e SHBA drejt Kinës në shumën mbi 110 miliardë dollarë. Përveç mbitaksave, SHBA dhe Kina e shtrinë luftën tregtare edhe në bllokimin e importeve dhe eksporteve ndërmjet tyre të mjaft produkteve e shërbimeve konkrete, sidomos produkteve bujqësore amerikane. Ajo u shtri dhe në territorin teknologjik. SHBA ndaloi rrjetet amerikane të telekomunikacionit të shisnin pajisje në Kinë, veçanërisht për gjigandin kinez të telekomunikacionit, Huawei duke e konsideruar këtë të fundit si "kërcënim" për sigurinë e SHBA-ve. Pasojë e drejtpërdrejt e kësaj "luftë teknologjike", modelet smartphone të teknologjisë së lartë të Huawei-t, nuk do mundeshin të dispononin sistemet Android, e për pasojë, do privoheshin nga aplikacionet e Google. Rivaliteti u shtri edhe në gjigandët e rrjetit, Google, Amazon, Facebook, Apple dhe ekuivalentëve të tyre kinezë s: Baidu, Alibaba, Tencent, Xiaomi.

Por lufta tregtare nuk u mjaftua me kaq; ajo u shtri edhe në politikën monetare dhe kurset e këmbimit. Në përgjigje të "sulmit amerikan" mbi eksportet kineze, Pekini zhvlerësoi monedhën e tij yuan-in në një nivel më të ulët në raport me dollarin se viti 2008, me gjithë rreziqet dhe humbjet që një veprim i tillë paraqiste për tërheqjen e investimeve të huaja dhe flukseve të kapitalit në ekonominë kineze. Ky veprim ndikoi ndjeshëm në minimizimin e efekteve të taksave doganore amerikane. Amerikanët e cilësuan menjëherë shtetin kinez si "manipulator monedhash". Në këtë vorbull u përzënë menjëherë edhe bankat qendrore të Indisë, Zelandës Re, Tailandës dhe tregjet monetare aziatike. Në të njëjtën kohë dhe FED-i njoftoi ulje të normës bazë të interesit, veprim që nuk e kishte bërë që nga viti 2008.

Kjo situatë "luftë" me "sulme e

kundërsulme" vazhdoi gjatë gjithë vitit 2019 pa shfaqur thajse asnjë shenjë për një "paqe tregtare e ekonomike" ndërmjet këtyre fuqive botërore. Por cili fitoi dhe cili humbi në këtë luftë tregtare? Përtej SHBA-së dhe Kinës, çfarë pasojash dhe ndikimesh pati kjo luftë tregtare në vendet e BE-së, vendet e tjera aziatike, në Afrikë e Amerikën Latine, apo edhe në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Shqipëri?

Në SHBA, një pjesë e rëndësishme e korporatave importuese e eksportuese të mallrave dhe shërbimeve kineze filluan ta vuajnë këtë politikë agresive tregtare. Grupime të fuqishme të sektorit industrial dhe agro-ushqimor amerikan i kërkuan publikisht administratës Trump që "t'i jepte fund tarifave ndëshkuese për importet e çelikut dhe aluminit; prodhuesit e mishit në SHBA u ankuan se kishin humbur mbi një miliardë dollarë, brenda disa muajve; prodhuesit e sojës reklamuan një humbje prej 77% të fitimeve të tyre, si efekt i tarifave ndëshkuese kineze ndaj eksporteve amerikane; qeveria amerikane u detyrua t'u paguante fermerëve të saj një "ndihmë" prej 28 miliardë dollarësh për t'u kompensuar humbjet nga acarimi i marrëdhënieve tregtare me Kinën; sipas universitetit të Kalifornisë lufta tregtare do t'i kushtonte rreth 70 miliardë dollarë në vit konsumatorëve amerikanë, ose 225 dollarë/person, etj.

Edhe Kina vuajti ndjeshëm nga kjo situatë "luftë tregtare". Vlerësohet se Kina ka humbur rreth 5 milionë vende pune dhe mbi 35 miliardë dollarë nga kjo situatë. Pasi taksoi, si kundërpërgjigje ndaj qëndrimit amerikan, disa mijëra produkte amerikane, duke pësuar pak a shumë të njëjtat efekte si ekonomia amerikane, Pekini "surprizoi" me futjen në fushën e betejës të "armës monetare", duke i bashkëngjitur luftës tregtare, edhe luftën e monedhave. Kjo politikë konsistonte në uljen e vlerës

së monedhës kineze, kundrejt dollarit, në mënyrë që eksportet kineze të bëhen më të lira e më konkurruese, duke anuluar në një farë mënyrë efektet e tarifave shtesë amerikane. Por ky veprim kinez, përveç reagimit mjaft të ashpër nga SHBA, shkaktoi panik në tregjet financiare, të cilat i trembeshin faktit se kjo luftë ndërmjet dy superfuqive më të mëdha të botës mund të shkaktonte dëme anësore në ekonominë dhe stabilitetin financiar e monetar në Evropë dhe vendet BRICS (Brazil, Rusi, Indi, Kinë, Afrika e Jugut).

Shqetësime të mëdha u krijuan dhe në Evropë, duke arritur deri atje sa të deklarohet se "Evropa do të ishte humbësja e madhe e këtij konflikti Kinë-SHBA". Lufta e monedhave Kinë-SHBA dhe zhvlerësimet reciproke të monedhave të tyre, USD dhe yuan-i, mund të provokonte rritjen e vlerës së Euros, uljen e konkurrueshmërisë së eksporteve të saj industriale, rrezikun e një lufte të hapur në import – eksportet e sektorit të automobilave dhe produkteve agro-ushqimore, duke shtuar rrezikun e shfaqjes së prirjeve recesioniste. Presidenti amerikan ka deklaruar se "BE-ja na shkakton po aq të këqia sa edhe Kina", çka nënkupton se në horizont mund të fillojë dhe një luftë e hapur tregtare SHBA-BE.

Ndërkohë, në listën e përfituesve nga kjo situatë po shfaqen vende si: Tajvani, Meksika, Japonia, Koreja e Jugut, Kanadaja, Turqia, Vietnami, India, Bangladeshi, Indonezia, Singapori, Rusia, një grup tjetër i madh vendesh anëtare të CNUCED, etj. Përfitimet e tyre burojnë nga faktorë të tillë si: rritja e mundësive të eksporteve dhe importeve të tyre në SHBA e Kinë; de-lokalizimin e një numri të madh shoqërisht prodhues në këto vende, të cilat largohen nga Kina apo SHBA për t'ju shpëtuar sanksioneve tregtare; rritjen e vendeve të punës në sektorët e lidhur me eksportin; tërheqjen më masive të investimeve të huaja direkte, etj.

OBJEKTIVAT PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM



ALPHA BANK

OBJEKTIVI 5

Banka mbështeti organizimin e edicionit të dytë të Festivalit të Jazz NYOU, ku të ardhurat nga festivali shkuan për organizatën "Strehëza për gra dhe vajza".

OBJEKTIVI 17

Banka ndërmori nisma të shumta në lidhje me të prekurit nga tërmeti i datës 26 nëntor, si: shpërndarje të ndihmave emergjente, organizim veprimtarie dhe shpërndarje dhuratash për më shumë se 80 fëmijë, të vendosur në hotelet e qytetit të Durrësit, blerje biletash në Koncertin e Bamirësisë: "Ti nuk do të jesh kurrë vetëm". Me mbështetjen e Grupit Alpha Bank u transferuan fonde në llogarinë e fondeve të emergjencës, ku u transferua edhe fondi i planifikuar për shporta festive për bashkëpunëtorët. Një sërë nismash u ndërmorën dhe nga Departamenti i Burimeve Njerëzore të bankës për stafin e prekur.



OBJEKTIVI 2

Banka në bashkëpunim me Food Bank Albania, ndërmori nismën vullnetare të "Dhurimit të produkteve ushqimore", duke grumbulluar 2,5 ton produkte ushqimore, që u shpërndanë në 125 familje në nevojë.

OBJEKTIVI 3

Banka mbështeti:

- Kongresin e Vtë: "Kujdesi gjatë shtatzënisë dhe lindjes", më 24-26 tetor, në Tiranë.
- "Hope Albania" për Halloween 70s theme party, një festë për të luftuar stigmën dhe diskriminimin që ekziston rreth shëndetit mendor në Shqipëri.
- Për të tretin vit rresht fushatën

e ndërgjegjësimit për zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit, duke iu bashkuar ecjes simbolike, në tetor në Tiranë, nën moton "Fjongo Rozë më kujton"!

- Koncertin e bamirësisë, në mbështetje të "Fjongo Rozë", nga artistja Ermonela Jaho, ambasadore e YWCA në Kauzën e Fjongo Rozë, në 22 tetor. Të të ardhurat e këtij koncerti i kaluan YWCA për ngritjen e një qendre psiko-sociale dhe ligjore për gratë dhe vajzat e prekura nga kanceri i gjirit dhe familjarët e tyre.

OBJEKTIVI 4

Banka mbështeti:

- Organizimin e mbledhjes së 7-të të Rrjetit Shqiptar për Edukimin Financiar (ANFE), 13 nëntor.
- Trajnimin: "Rruga Drejt Suksesit" nga Vasil Naçi, 8-10 nëntor 2019.

OBJEKTIVI 11

ABI Bank mbështeti, për të tretin vit radhazi, Edicionin e Muzeut të Stilit "Ethno Vibe", organizuar për Ditën e Trashëgimisë Kulturore, në 28 shtator, në Pazarin e Korçës.

OBJEKTIVI 17

Banka ishte mbështetëse e partnere financiare e Konferencës së 41-të Ndërkombëtare të Komisionarëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë, më 22-24 tetor në Tiranë.


ART SPORT KULTURE

ABI Bank ishte sponsor gjeneral i edicionit të 21-të të Festivalit Ndërkombëtar të Teatrit, në Teatrin "Skampa" Elbasan, në 10 - 17 tetor.



OBJEKTIVI 11

Financimi pa interes për të pastrehët nga tërmeti është një produkt që BKT ka për qëllim t'i ofrojë individëve



të prekur nga tërmetet e ndodhura në Shqipëri, në 21 shtator dhe 26 nëntor 2019, në formën e blerjes së një pasurie të patundshme me një çmim të dakordësuar mes palëve sipas së cilës klienti është dakord të përdorë pronën në këmbim të qirasë për një afat të përcaktuar gjatë së cilës qiramarrësi do t'i paguajë qira bankës.

OBJEKTIVI 3

- Edicioni i 4rt i Maratonës së Tiranës mirëpriti garues nga 42 vende të botës, ku pjesë e tyre ishin edhe anëtarët e stafit të BKT-së.
- Dhuro gjak, shpëto jetë! BKT zgjodhi që, së bashku me stafin e saj, të jetë pranë personave që kanë nevojë për gjak.
- Përfaqësues të Fondacionit "Down Syndrome Albania" ndoqën veprimtarinë e shitjes së kartolinave të dizenuara sipas pikturave të fëmijëve që janë diagnostikuar me Sindromën Down, pranë zyrave qendrore të BKT.

OBJEKTIVI 4

- University of New York Tirana (UNYT) mirëpriti BKT në mjediset e kampusit të tij për të prezantuar së bashku projektin më të fundit të bashkëpunimit. Falë kësaj marrëveshjeje, BKT do të ofrojë për studentët më të mirë të UNYT 10 bursa studimi dhe 20 praktika mësimore të paguara, për çdo vit akademik. Më tej, procesi i rekrutimit do të finalizohet me punësimin e studentëve.
- Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës (UAMD), organizoi ceremoninë e diplomimit të studentëve të Fakultetit të Studimeve të Integruara me Praktikën (FASTIP). Një kënaqësi e veçantë, e dhuruar nga BKT për studentët diplomantë dhe prindërit e tyre për vitin 2019, ishte punësimi i 14 studentëve në periudhën korrik - 1 shtator, shumë më përpara se të diplomoheshin!
- BKT dhuroi mobilje për t'u përdorur në shkolla të ndryshme publike, si

dhe duke blerë pajisje të reja si: 2 PC, 2 laptopë dhe 2 printera për Zyrën Arsimore Kamëz.

- BKT mbështeti Universitetin "Luigj Gurakuqi" në organizimin një takim-diskutimi me temë: "Sfidat e Zhvillimit Rajonal".
- Qendra e Zhvillimit "Pëllumbat"
- Fëmijët e Qendrës së Zhvillimit "Pëllumbat", edhe këtë vit i festuan festat e fundvitit së bashku me stafin e BKT-së.



OBJEKTIVI 2

- Credins Bank bashkë me stafin e saj u organizua duke dhuruar ushqime në ditën botërore kundër urisë, bashkë me Kryqin e Kuq Shqiptar.
- Credins, mbuloi shpenzimet e disa fëmijëve të fshatit SOS, duke u dhënë atyre më shumë mundësi e duke investuar në një shtëpi të lumtur.

OBJEKTIVI 3

Banka mbështeti:

- Spitalin Obstetrik Gjinekologjik "Mbretëresha Geraldinë" në blerjen e krevateve që shërbejnë për sallë operacioni.
- Projekte për të ndihmuar në përmirësimin e kushteve të punës, ku më të spikatura janë: Spitalit Rajonal Vlorë, ku sponsorizoni blerjen e 5 poltronëve për kimioterapi dhe Durrës në përmirësimin e kushteve të Maternitetit.



OBJEKTIVI 4

Në Ditën Ndërkombëtare të Kursimit, Credins Bank vendosi të ishte pranë nxënësve të shkollës 9-Vjeçare "Edith Durham", me pjesëmarrjen e z.Rinald Gjyli, zv.Drejtor i Thesarit.

OBJEKTIVI 9

Banka mbështeti:

- Spitalin "Ihsan Cabej", për



restaurimin e mjediseve.

- Komandën e Forcës Tokësore në përmirësimin e infrastrukturës.
- Qendrën Shëndetësore Nr.1 dhe Qendrën Shëndetësore Kodër-Kamëz, për restaurimin e mjediseve.
- Drejtorinë Arsimore Fier dhe Drejtorinë Rajonale Arsimore Fier, në përmirësimin e mjediseve.
- Qarkun Dibër, për të përmirësuar infrastrukturën dhe kushtet e mjediseve të punës.
- Blerjen e pajisjeve kompjuterike për Zyrën Vendore Arsimore Kamëz.

OBJEKTIVI 17

Credins Bank, sponsorizoi dhomën AmerikanetëTregtisë, në organizimin e Ditës së Falenderimeve. Gjithashu, banka mbështeti dhe Zyrën Vendore Arsimore Shkodër, në zhvillimin e veprimtarisë së fundvitit.

KULTURË, ART DHE SPORT

Banka mbështeti:

- Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në organizimin e panairit: "Shqipëria punon tokën".
- Komandën e Forcës Detare në organizimin e Ceremonisë Zyrtare me rastin e 94 vjetorit të krijimit.
- ITCSmedia edhe veprimtari që përkrahin promovimin e startup-eve më novatore në Shqipëri, Kosovë dhe rajon. Banka ishte sponsori kryesor i Uplift Albania, akseleratorit më të madh në vend për startup-et më novatore në Shqipëri, Kosovë dhe rajon.
- Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës, në organizimin e ceremonisë së diplomimit të studentëve.
- Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, si dhe mundësoi dhënien e çmimeve të eventit: "Colours of Albania".
- Bashkinë Skrapar, duke sponsorizuar organizimin e

veprimtarisë: "Skrapari në gotë".

- Festivalin e 11-të në Bunk'Art1.
- "I'm from Tirana", një show nga Kujtim Prodani, që u mbajt pranë "Teatrit Eksperimental ArTurbina".
- Shoqatën Partizani VOLEJ, Meshkuj.
- Veprimtarinë "Mandarina Fest 2019".
- Realizimin e eventit kulturor: "Çmimet Kult".




OBJEKTIVI 3

- Më 2 tetor, Fibank Albania u bashkua me Kryqin e Kuq të Shqipërisë për organizimin e ditës së dhurimit të gjakut..
- Me 13 tetor 2019, Fibank Albania u bë pjesë e edicionit të 4rt të Maratonës së Tiranës 10 dhe 21K.
- Të gjitha fondet e mbledhura gjatë muajit tetor, përfshirë ato të dhuruara nga banka, shkuan për një anëtare të stafit të Fibank, për të mbështetur rrugëtimin e saj për mposhtjen e kësaj sëmundje.
- Fibank, për të dytin vit radhazi, sponsorizoi shfaqjen: "Dance with Me" në TV Klan.
- Fibank sponsorizoi projektin e parë të qendrës sociale "MamiCare", për nënat dhe të porsalindurit e tyre në Tiranë.

OBJEKTIVI 4

- Fibank Albania, në bashkëpunim me shoqërinë trajnuese EPPC, zhvilluan gjatë gjithë muajit tetor trajnimin e forcës së shitjes së Bankës në: "EKSPERIENCA E KLIENITIT - Një lidhje e jetës".
- CyberCon Albania/10 tetor 2019. Përmbajtja e një edukimi të tillë duhet të jetë e nevojshme, me fokus në aspektet njohëse dhe jo-njohëse të të mësuarit, të organizuar nga Instituti Kanadez i Teknologjisë, në bashkëpunim me



ICT Academy dhe Ecronex Media.

- Departamentet e Fibank organizuan trajnime mbi: "Procedurat me paranë e gatshme dhe ato operacionale", për përditësimet më të fundit dhe zbatimet e tyre.
- Më 2 nëntor u organizua një trajnim për stafin rreth pastrimit të parave, sigurimit të depozitave, menaxhimit të rrezikut operacional, transakcioneve bankare, të rejat mbi kartat bankare, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit.
- Fibank mbështeti koncertin recital: "Ana tjetër e imja", në Teatrin Bylis, Fier, më 19 dhjetor 2019.

OBJEKTIVI 8 & 11

- Dita Ndërkombëtare e Personave të Moshuar/1 tetor 2019. Tema për vitin 2019 ishte: "Udhëtimi për barazinë moshore". Fibank u uroi të gjithë klientëve të tij të moshës së artë me një xhest të këndshëm, duke dhënë kontribute në llogaritë e tyre të pensioneve, e duke u uruar atyre shëndet dhe mirëqenie.
- Hapja e Degës së re të Bulevardi "Zogu I". Kjo degë u lançua me një produkt të veçantë huaje konsumatore, me komision zero për disbursim, posaçërisht për të gjithë klientët e rinj Fibank të asaj zone.

OBJEKTIVI 17

- #Takohe mi ne... / tetor - dhjetor 2019. Partneriteti i ri i Fibank Albania me Globus Travel do të sjellë një mundësi të shkëlqyer për klientët, që të rezervojnë pushimet e tyre të udhëtimit me zero norma interesi për këto lloj huash konsumatore.
- Më 11 dhjetor, Fibank nënshkroi një marrëveshje partneriteti me Fondacionin e Garancisë së Kredisë Rurale në Shqipëri.



OBJEKTIVI 1

- Punonjësit e Bankës mbështetën nismën e Fshatit SOS, për të dytin vit radhazi, duke blerë 222 kartolina bamirësie të përgatitura nga fëmijët.
- Banka mbështeti me një donacion Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, me rastin e festave të fundvitit, të organizuara për të mbështetur familjet e 226 oficerëve të policisë të rënë në krye të detyrës.
- Në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar, punonjësit e bankës mblodhën vullnetarisht një sasi të konsiderueshme rrobash për fëmijë e të rritur.

Objekti 2


Banka bashkëpunoi me Food Bank Albania, për të ndihmuar familjet në nevojë. Në të gjitha degët e Tiranës, Durrësit, Shkodrës, Lezhës, Kavajës, Fierit, Lushnjës, Elbasanit dhe Korçës punonjësit e bankës dhuruan 760 kg ushqime.

OBJEKTIVI 3

Punonjësit e Intesa Sanpaolo Bank Albania u bashkuan për të 11-tin vit radhazi me nismën: "Gjak i sigurt për të gjithë", në bashkëpunim me Bankën Shqiptare të Gjakut.

OBJEKTIVI 4

- Intesa Sanpaolo Bank Albania mbështeti, për të dytin vitin radhazi, konkursin me temë: "Big Data Analysis", të organizuar nga EESTEC Tirana, ku morën pjesë studentë nga universitete të Tiranës..
- Me rastin e Ditës Botërore të Kursimit, 31 tetor 2019, banka iu bashkua, për të tretin vit radhazi, nismës së suksesshme ndërkombëtare: "ARTI I KURSIMIT", të Grupit Intesa



Sanpaolo & Muzeut të Kursimit (Museo del Risparmio), Gallerie d'Italia & Arkivit Historik.

OBJEKTIVI 9

Banka mbështeti Skuadrën Shqiptare të Robotikës, që përfaqësoi vendin në FIRST Global Challenge, që u zhvillua në 24-27 tetor në Dubai, ku 5 të rinj prezantuan robotin e krijuar prej tyre dhe arritën deri në fazën finale, ku fituan vendin e dytë për çmimin: "Clara Barton Award for Helping Hands".

OBJEKTIVI 10

Skuadra e Intesa Sanpaolo Bank Albania e përbërë nga 35 punonjës, mori pjesë në Edicionin e 4rt të Maratonës së Tiranës, në 13 tetor 2019. Pjesëmarrja e punonjësve shërbeu si kontribut i drejtpërdrejt për mbështetjen e fushatës së UNHCR: "2 miliardë Km për sigurinë", në mbështetje të refugjatëve.

OBJEKTIVI 17

Pas tërmetit të 26 nëntorit 2019, banka ndërmoi menjëherë masa konkrete, për t'u ardhur në ndihmë familjeve të prekura. U hoqën komisionet për të gjitha depozitimet në llogaritë e hapura në ndihmë familjet e prekura nga tërmeti, qoftë nga institucione shtetërore ose OJQ. U hartuan skema financiare të hartuara posaçërisht për qytetarët dhe subjektet juridike të prekura nga tërmeti. Gjithashtu, punonjës të degëve Fier dhe Lezhë dhuruan ndihma për familjet e prekura nga tërmeti. Në llogaritë e hapura për mbledhjen e fondeve për të dëmtuarit nga kjo fatkeqësi natyrore punonjësit e bankës kontribuan vullnetarisht.



OBJEKTIVI 1

Raiffeisen Bank iu bashkua të gjithë

qytetarëve dhe institucioneve, në nismën për të mbështetur të prekurit nga tërmeti shkatërrues. Stafi i bankës nëpërmjet nismës: "Raiffeisen për Shqipërinë" iu gjend pranë të gjitha familjeve të lënduara, duke dhuruar ushqime, veshmbathje, batanije dhe ndihma të tjera të nevojshme për të kaluar ditët e vështira.

OBJEKTIVI 3

Raiffeisen mbështeti Spitalin Rajonal Berat, në projektin e rëndësishëm të përmirësimit të mjediseve spitalore, veçanërisht repartit të kirurgjisë. Gjithashtu, një tjetër projekt, i mbështetur nga banka ishte dhe rikonstruksioni i pjesës së spitalit Rajonal Korçë.

OBJEKTIVI 4

- Fillimi i vitit të ri akademik, e gjeti Fakultetin Ekonomik në Universitetin e Tiranës me një laborator të ri informatike, të mundësuar nga Raiffeisen Bank.
- Fëmijët e kopshtit "Buzëqeshja" në Gjirokastrë e nisën vitin e ri edukativ me mjedise të reja dhe shumë komode, falë mbështetjes që banka i dha Bashkisë Gjirokastrë për rikonstruksionin e plotë të mjediseve të kopshtit.




OBJEKTIVI 9

Raiffeisen mbështeti:

- Për të katërtin vit radhazi konferencën e marketingut digjital: AllWeb.
- Edicionin e parë të "Tirana Tech Open 2019", që kishte në fokus nxitjen e inovacionit dhe krijimtarisë në sektorin e shërbimeve të teknologjisë.

OBJEKTIVI 11

Raiffeisen Bank mbështeti Bashkinë e Tiranës, në projektin "Karta e studentit", duke ofruar edhe një paketë me shërbime falas për të gjithë të rinjtë që kanë një kartë studenti.



ART, SPORT DHE KULTURË

Raiffeisen Bank mbështeti:

- Dramën "Engjëjt e Amerikës".
- Grand Gala "Alles Walzer".
- Koncertin "Ti nuk je vetëm".
- Baletin "Zhizel".
- Opereta "Die Fledermaus".
- Koncertin "Tre Tenorët".
- Shoqatën "Tenis Tirana", në projektin "Sport për shëndet".



Grupi OTP njoftoi kontributin personal në shumën 500,000 Euro, për lehtësimin e dëmeve dhe në ndihmë të njerëzve të prekur nga tërmeti i fortë i 26 nëntorit 2019. Në të njëjtën kohë, nisi në nivel grupi një fushatë për grumbullim fondesh, përmes së cilës çdo filial i OTP-së mund të kryejë dhurim personal. Kryqi i Kuq Hungarez po mbledh donacione private për të ndihmuar viktimat e tërmetit. Dhurimet do të shpenzohen për asistencë, në furnizime të përditshme dhe në rindërtim afatgjatë të zonave të prekura.

TIRANA BANK

OBJEKTIVI 1

- Duke marrë shkas nga transmetimi i rastit të familjes Poka në emisionin "Stop", kushteve të tyre të vështira të jetesës, presidenti i Grupit Z.Mane, reagoi menjëherë, duke i dhuruar një shtëpi në pronësi të Tirana Bank.
- Tirana Bank, me misionin për të mbështetur familjet në nevojë, këtë fundvit ka qënë pranë fëmijëve në zonën e Vorës, familjet e të cilëve u prekën nga tërmeti. Në bashkëpunim me Kryqin e Kuq u ndërmor nisma për të organizuar festën e Vitit të Ri për 50 fëmijë.

OBJEKTIVI 3

Tirana Bank mbështeti "Maratonën e Tiranës", një ngjarje e përvitshme dhe me përmasa gjithnjë e më të mëdha, për sa i takon pjesëmarrjes.

UNIONBANK

OBJEKTIVI 7


Union Bank prezantoi në edicionin e tretë të panairit "Energy Expo & Forum 2019", 4-5 tetor, kredinë Kursim+, e cila iu dedikohet atyre klientëve individë që dëshirojnë të kryejnë në banesat e tyre investime. Union Bank ofron këtë produkt në bashkëpunim me BERZH.

OBJEKTIVI 9

- Union Bank lidhi në datë 11 dhjetor 2019 një marrëveshje me Fondin për Garantimin e Kredive Rurale (RCGF), që ka për qëllim zgjerimin dhe lehtësimin e aksesit në financime për sipërmarrës dhe fermerë shqiptarë.
- BERZH nënshkroi Marrë-veshjen për Ndarjen e Rrezikut me Union Bank. Ndërmarrjet shqiptare do të përfitojnë akses më të mirë në financim tashmë, falë marrëveshjes për ndarjen e rrezikut, prej 30 milion Eurosh, që znj. Charlotte Ruhe, Drejtore Rajonale për Evropën Qendrore dhe Juglindore, BERZH, nënshkroi me z. Gazmend Kadriu, Drejtor i Përgjithshëm i Union Bank.

OBJEKTIVI 10

Gjatë muaji dhjetor Union Bank lançoi fushatën: "Bamirësi me kartat Union Bank". Kjo fushatë ndërgjegjësimi bëri të mundur plotësimin e dëshirave të fëmijëve të Fshatit SOS për dhuratat e festave të fund vitit.



AAB AKTIVITETE

Udhëtim trajnimi me gazetarët ekonomikë

Këtë vit, trajnimi u organizua në 20 - 22 tetor, në Torino, Itali dhe u mbështet nga Intesa Sanpaolo Bank - Albania & Intesa Sanpaolo Group.

Takim-diskutimi i organizuar nga AAB dhe VISA

Më 24 tetor, AAB bashkëpunoi me VISA dhe organizoi një takim-diskutimi me praninë e dy ekspertëve të VISA CEMEA: Znj. Anzhela Kashperuk dhe Z. Srdjan Tutoric.

Takim-diskutimi për Sigurinë Kibernetike

Më 29 tetor, AAB me mbështetjen e Njesisë për Zhvillim të Fondit Evropian për Evropën Juglindore, (EFSE DF), organizoi takim-diskutimin me temë: "Hack for Life".

Veprimtaria e Kontrollit të Pagesave me SWIFT

Më 6 nëntor, AAB bashkëpunoi me SWIFT-in dhe organizoi një takim-diskutimi me praninë e ekspertëve të SWIFT-it: Znj. Gizem Tansu, ICA, Nismat e Përputhshmërisë për Krimin Financiar - EMEA.

Fushata e ndërgjegjësimit për përdorimin e kartave

AAB, me mbështetjen e MasterCard, e zgjeroi edhe më tej fushatën e ndërgjegjësimit për përdorimin e kartave. Fushata konsistoi në një spot televiziv, që u transmetua në disa kanale televizive kombëtare. Për më tepër, fushata përfshiu platforma të ndryshme të mediave sociale.

Ligji: Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat

AAB u dërgoi një letër autoriteteve përkatëse, duke kërkuar rishikimin e Ligjit Nr. 26/2019: "Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat".

Tryezë e rrumbullakët: "Rigjallërimi i huadhënies dhe zvogëlimi i huave me probleme"

Më 6 dhjetor, Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB), në bashkëpunim me Korporatën Ndërkombëtare Financiare (IFC) dhe me mbështetjen e SECO-s, organizuan një tryezë të rrumbullakët me temë: "Rigjallërimi i huadhënies dhe zvogëlimi i huave me probleme".



TRAJNIME

AAB organizon trajnime Tetor - Dhjetor 2019

Risi në Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, organizuar më 10-11 tetor në bashkëpunim me AIMS International Albania.

Ekipet e Udhëheqjes në 21-22 tetor dhe **Menaxheri si Trajner** në 23-24 tetor, në bashkëpunim me AIEA.

Menaxhimi i rrezikut: Menaxhimi i pasurive dhe detyrimeve, organizuar më 23-25 tetor, në bashkëpunim me ATTF.

Points of You® Academy në Shqipëri, në partneritet me AIEA dhe Galagan Advisory. Më 25 tetor u organizua takim-diskutimi: Level 1 - Hello Points.

Udhëzuesi për ndërtimin e një Angazhimi Kulturor, 21 nëntor, në bashkëpunim me Lincoln Center.

Takim-diskutimi i Greenback Academy, organizuar më 18 dhjetor, Banka Botërore, Banka e Shqipërisë dhe Shoqata Shqiptare e Bankave.

